



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Departamentit i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit.**

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", nr.2, Tiranë; Tel: 04251-26 E-mail: klsh.org.al; Eeb-site:ëëë.klsh.org.al

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më 30.09.2019

**V E N D I M**  
**Nr.97, Datë 30/9/2019**

**PËR**  
**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË**  
**DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT,**  
**PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT QARKU TIRANË "MBI ZBATIMIN**  
**E PËRPUTHSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË, NË AKTIVITETIN**  
**EKONOMIKO FINANCIAR", për periudhën nga data 01.10.2016 deri më**  
**datën 01.01.2019.**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Drejtorisë të Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

**V E N D O S A:**

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "*Për auditimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë në aktivitetin ekonomik financiar*" për kryerjen e inspektimeve lidhur me zbatimin e kontrollin e akteve ligjore e nënligjore në fushën e inspektimit të mbrojtjes së mjedisit e pyjeve të ushtruar në DRISHMPUT Tiranë me programin e auditimit nr.14/1, datë 7.01.2019 për periudhën 01.10.2016 deri më 01. 01.2019.

**II.** Të miratoj Opinionin e auditimit, rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

## A. OPINIONI AUDITIMIT

### **Baza për opinionin: (ISSAI 4000<sup>1</sup>):**

KLSH ka audituar veprimtarinë e DRISHMPUT Qarku Tiranë në mbështetje të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe ISSAI 1700 dhe ISSAI 4000.

Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e **manualit të auditimit të përputhshmërisë**<sup>2</sup>: dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit. Sipas kërkesave etike, te cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet buxhetore, KLSH është e pavarur nga DRISHMPUT Qarku Tiranë dhe përgjegjësitë e tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për opinionin tonë.

Nga auditimi i përputhshmërisë, mbështetur në standardet e INTOSAI-t dhe Manualit të Përputhshmërisë të KLSH-it, kryer në Degën Rajonale të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmi (DRISHMPUT) Qarku Tiranë, rezultuan devijime nga kuadri ligjor rregullator në fuqi (kriteret) dhe konkretisht:

**a.** -DRISHMPUT Tiranë, që ushtron aktivitetin në juridiksion Qarku në 5 Bashki Tiranë, Kamëz, Vorë, Kavajë dhe Rrogozhinë, për periudhën objekt auditimi nga data 01.09.2016 deri më 01.10.2018, ka kryer 1429 inspektime, ndarë 1147 inspektime ne mjedis dhe 282 në Pyje kullota; prej tyre në v.2018 me metodën on-line 194 inspektime 190 në mjedis dhe 4 në pyje; tregues i pamjaftueshëm për mundësim dhënie opinionin të arritjes objektivit kryesor, duke u mbështetur vetëm në numrin faktik të inspektimeve, pasi ka munguar plani i miratuar i inspektimeve për secilin prej 3 viteve 2016, 2017 dhe 2018, dhe për shkak të mungesës së bazës së krahasimit, nga Grupi i auditimit u bë evidentimi dhe listimi i numrit të inspektimeve të kryera duke hartuar tabelat përkatëse të realizimit faktik.

**b.** Nga DRISHMPUT Tiranë nuk është hartuar dhe miratuar plani vjetor i inspektimeve mbështetur në përcaktimin, argumentimin e zgjedhjes së subjekteve dhe fushave për inspektim mbi bazën e riskut si dhe regjistrin të riskut,

**c.**-Në kryerjen e inspektimeve janë konstatuar mangësi e parregullsi në mbajtjen e dokumentacionit të inspektimeve, planeve vjetore, parashikimin e riskut, në sistemimin, arkivimin, përmbledhjen e dokumentacionit përbërës: Autorizim inspektimi, procesverbal inspektimi, procesverbal kundravajtje, raport përmbledhës të inspektimit deri në ekzekutimin e gjobave, sekuestrimeve, procesverbaleve të vlerësimit të demit (PVD) etj,

**d.** Nga auditimi i kryerjes së inspektimeve rezultuan me mangësi e shkelje 298 praktika inspektimesh kundrejt 1429 inspektime të kryera ose 21 % sipas fushave:

**- në mjedis 230 inspektime** ose 20.% kundrejt 1147 gjithsej, në kundërshtim me ligjin nr.10431 datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” seksioni 2 neni 62-66 “Inspektimi për mbrojtjen e Mjedisit”, me ligjin nr.10433 datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” nenin 45-48 dhe me ligjin nr.10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, neni **29, pika1/ii**, “Kundërvajtjet”

**- në pyje kullota 60** inspektime ose 21,2 % kundrejt 282 inspektimeve; mangësi në autorizimet e inspektimit, procesverbalit të inspektimit, ne plotësimin, mosdërgimin për ekzekutim të procesverbaleve të vlerësimit të demit, në plotësimin e vendimit përfundimtar të inspektimit; në kundërshtim me nenin 45 pikat 1,2,3,4, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011”Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe në mos përmbushje të kërkesave të ligjit nr. 9385, datë 23.04.2009

<sup>1</sup> ISSAI 4000 – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta.

<sup>2</sup> Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”.

“Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, neni 12 dhe me Manualin e Përgjithshëm të Inspektimit në Republikën e Shqipërisë, si dhe VKM nr. 396, datë 21.06.2006,

e.- Numër i kufizuar i inspektimeve me metodën on-line, kryesisht inspektimet në pyje, në moszbatim të urdhrin nr. 284, datë 3.5.2018 “Për Kryerjen e Inspektimeve On-Line” kjo për 2 grup shkaqesh:

1. Shkak të sistemit lidhur me mangësitë dhe nevojën për modifikimin e përfshirjes në programin e inspektimeve on-line të 5 formateve të procesverbaleve; zgjidhjen, përfshirjen në sistem të 3 problemeve lidhur me identifikimin përcaktimin e ekonomive, ngastrave pyjore, kullosore, zonave të mbrojtura objekt inspektimi, identifikimin e kundravajtësit në kushtet e flagrancës, kur nuk kanë apo nuk paraqesin kartën ID (në ekonomit pyjore, kullosore, në rrugë auto etj); -Problemi i planeve mujore apo vjetore të punës sipas ekonomive pyjore, kullosore, zonave të mbrojtura, gjueti etj, pasi sistemi i inspektimit on-line pranon vetëm subjekte me nr Nipt, gjë e cila në ekonomit pyjore, kullosore etj nuk ekziston, nuk i përshtatet; për të cilat kemi propozuar masat për rregullimet.

2. Nevoja për përmirësim afatesh ligjore për inspektimet në pyje, në harmonizim dhe zbatim të dy ligjeve nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” në kryerjen e inspektimeve në fushën e pyjeve në drejtim rregullimit dhe përputhjes afateve ndërmjet neneve 45 dhe 46 të Ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” me nenin 38 të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” të ndryshuar,

-rishqyrtimin dhe ndryshimin e afateve përcaktuar (prej 3 dhe 5 ditë) lidhur me dërgesat e njoftimeve të praktikave inspektuese, duke i rritur deri në 1 javë, për inspektimet që kryhen në Sektorin Pyjor, nisur nga veçoritë e inspektimeve në Sektorin e Policisë Pyjore lidhur me hapësirën dhe shtrirjen territoriale, gjendjen dhe lëvizjen e selive (adresave) të subjekteve me veprimtaritë në fondin pyjor, dhe vonesat në rastet e dërgesave të njoftimeve të praktikave inspektuese me pasoja humbje të çështjeve në gjykata; për të cilat kemi propozuar rishqyrtimin dhe masat për përmirësim ligjor në nenet 32 dhe 45 të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, në harmonizim me ligjin nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar.

f. DRISHMPUT Tiranë, sektori i inspektimit Pyjor, nga inspektimet në pyje nuk ka dokumentuar e vënë nën administrim të subjekteve shtetërore në 11 raste me 64,8 mst dru zjarri dhe 25 m<sup>2</sup> lëndë punimi që i përkasin periudhës 3/mujori IV v. 2016 dhe v. 2017, në 6 raste për 49,8 mst dru zjarri dhe 25 m<sup>3</sup> lëndë punimi për të cilat nuk janë marrë vendime sekuestrimi, apo për moszbatim të pika 4 për sekuestrim të vendimeve nuk janë prerë fletëhyrje, me pasoje lënie dhe përfitimin e pa drejtë tek kundravajtësit të materialit drusor; ndërsa për v.2018 në 5 raste me 16 mst dru zjarri konstatuar dhe kapur gjatë transportit dokumentuar me 5 procesverbale të inspektimit nuk janë vënë nën administrim pra nuk janë dokumentuar me fletë hyrje, pasi rastet janë në ndjekje penale dhe nuk është vendosur sekuestro mbi materialin të ndodhur në Komisariate apo Prokurori

g. 1. DRIDHMPUT Tiranë Sektorin Pyjor për 3/muj IV v. 2016 deri v. 2017 për dëmtimet në pyje nga kundravajtësit prej 23 rasteve me vlerë dëmi 43,492.235 lekë, vetëm në 5 raste në vlerën 30,878,235 lekë ka hartuar Procesverbale Vlerësimi Dëmi (PVD), të cilat i ka kallëzuar në prokurori, ndërsa në 18 raste me vlerën 12,614,000 lekë, nuk janë hartuar PVD dhe nuk janë dërguar për arkëtim në bashkitë dhe në AKZM respektive.

2. DRIDHMPUT Tiranë Sektorin Pyjor në v. 2018, për dëmtimet në pyje nga kundravajtësit, prej 26 rasteve me vlerë dëmi 3,562,679,000 lekë, ku në 3 raste me vlerë 3,555,999,000 lekë (nr, 5, 16, 21) ka hartuar Procesverbale Vlerësimi Dëmi (PVD) dhe kallëzuar në prokurori (prej tyre Subjekti “XXX” shpk me vlerë dëmi 3,555,000,000 lekë), ndërsa në 23 raste me vlerën 6,680,000 lekë, janë hartuar PVD dhe janë në proces dërgimi për arkëtim që kanë sjellë pasoje vonesa në arkëtimin të vlerës prej 6,680,000 lekë,

h. DR ISHMPUT Tirane nuk ka vepruar për 49 raste në vlerën 8,590,000 lekë, prej të cilave:

për 23 rastet me **vlerën 6,900,000 lekë** për mos vendosje të masës minimale të gjobës nga inspektimet për shkeljet në mjedis, për **19 raste** subjekte për vlerën **190,000 lekë** në inspektime për verifikimin e detyrës në subjektet me kontrata të mbetjeve të rrezikshme; për **7 raste vlerën 1,500,000 leke, për mosvendosje gjobe** subjekteve që nuk kanë plotësuar kushtet e lejeve të lëna detyrë, nuk kanë paraqitur raportet e vetmonitorimi, në kundërshtim me ligjin nr.10431 datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” me ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” ligjin nr.10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, neni **29, pika 1/ii, i. DRISHMPUT Tiranë** për periudhën 2015, 2016, 2017 dhe 2018, për shkak të mos nxjerrjes e miratimit të aktit përkatës të kritereve të punësimit, zotëron strukturë të pa përshtatshme e të paqëndrueshme punonjësish me rreth 40, ku kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës e larguar nga shërbimi civil **31** punonjës ose **77,5%**, (13 inspektorë pyjesh me kontratë, 17 punonjës civil inspektorë mjedisi) me kohëzgjatje mesatare më pak se **1 vit e 6 muaj** me ndikim e mungesë të kualifikimit të nevojshëm; si dhe me nivel kualifikimi specialitet të pa përshtatshëm, jo funksionale dhe jo në përputhje me kriteret e kërkesat detyrat, funksionet përcaktuar në VKM nr. 103, datë 4.2.2015 “Për Krijimin dhe mënyrën e Organizimit të Funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave”.

**j. DRISHMPUT Tiranë** në hartimin, zbatimin ndjekjen menaxhimin e realizimit të treguesve të Buxhetit ka parashikime me rezerva, buxhete të pamjaftueshme, të pa argumentuar jo funksional me ndikim në numrin e inspektimeve, sidomos në distanca të largëta, nga mos përfshirja mosakordimi në zërin 602 “shpenzim transporti udhëtime dieta” dhe nivele të ulëta realizimi.

**Opinion i auditimit:** Nga auditimi i përputhshmërisë, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 4000, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH-së dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin DR ISHMPUT Tiranë nuk u konstatuan devijime materiale por devijime në kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, që janë **materiale dhe jo të përhapura**, për të cilën **japim opinion të kualifikuar<sup>3</sup>**.

## **B. PROPOZIME PËR PËRMIRËSIME LIGJORE**

**- Propozim për ndryshim dhe harmonizim të kuadrit ligjor në fuqi.**

**Gjetje 1:** Në kryerjen e inspektimeve në fushën e pyjeve me metodën on-line, diktohet nevoja për përmirësime ligjore në harmonizimin dhe zbatimin e të dy ligjeve nr.10433, datë 16.6.2011 dhe ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” në drejtimit e më poahme:

1. Në rastin e kryerjes së inspektimeve pa njoftim paraprak, referuar nenit 32, pika 2 të ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, është përcaktuar të kryhen inspektime në flagrancë për sektorin e Policisë Pyjore, ndërsa respektimi i afateve ligjore shprehur sipas nenit 45/ pika 4, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” mbi mbajtjen e procesverbaleve të inspektimit edhe për këto raste përcaktohet tekstualisht që: **“Procesverbali i inspektimit përmban, gjithashtu informacion për të drejtën e subjektit të inspektimit që të paraqesë me shkrim apo me gojë shpjegimet apo kontestimet e tij për faktet dhe rrethanat e konstatuara në procesverbal, brenda një afati të përcaktuar nga inspektori, por jo më të shkurtër se 8 ditë nga data e njoftimit të procesverbalit, për paraqitjen e këtyre komenteve, si dhe organin ku paraqiten këto komente. Pas kalimit të këtij afati, vendimi**

<sup>3</sup> -Sipas **Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë** të KLSH-së, (fq.66), kapitulli V, pika 5.4, “Opinion i kualifikuar”: Audituesi shpreh një konkluzion me rezerve kur në gjykimin profesional të tij, efekti ose efektet e mundshme të një çështjeje, nuk janë aq materiale sa që të justifikojnë një konkluzion të kundërt ose një refuzim të konkluzionit. Kur auditimi i përputhshmërisë kryhet së bashku me pasqyrat financiare, **audituesi mund të shpreh një opinion me rezerve kur devijimet janë materiale por jo të përhapura** ose n.q.s. audituesi nuk është në gjendje të sigurojë evidencë auditimit të përshtatshme dhe të mjaftueshme dhe, efektet e mundshme, janë materiale por jo të përhapura.

*përfundimtar mund të merret pa qenë i nevojshëm dëgjimi i mëtejshëm i subjektit të inspektimit. Shpjegimet apo kontestimet e subjektit të inspektimit janë pjesë e dosjes”.*

Nga ana tjetër, në Nenin 46/1, ”Shqyrtimi dhe marrja e vendimit përfundimtar” të po këtij ligji përcaktohet se: *“Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji i posaçëm, vendimi përfundimtar i inspektimit merret nga inspektori apo inspektorët që kanë kryer inspektimin, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të procesverbalit subjektit të inspektimit” .*

**Konstatimi: Respektimi i këtyre afateve (8 ditë dhe 30 ditë të marrjes së vendimit përfundimtar) krijon mundësinë që kundravajtësi të përpilojë, sigurojë dhe sjellë dokumentin përkatës ligjor, kështu që inspektimi në kushtet e flagrancës humbet efektivitetin dhe vlefshmërinë. Për këtë, në nenin 45 dhe 46 të ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të bëhen ndryshimet përkatëse në harmonizim dhe përputhje me ligjin nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” të ndryshuar, Neni 38, Pika 1, germa “o” ku shprehet: “...transporti me kamionë i materialit drusor nga pylli dhe prej shesheve të depozitimit për në qendrat e përpunimit e të shitjes, i pashoqëruar me lejen tip të transportit, dënohet me gjobë 80 000 deri në 100 000 lekë”; Germa “q” : tregtimi ose tjetërsimi i materialeve drusore dhe i prodhimeve të tjera, pyjore e jopyjore të fondit pyjor kombëtar, pa lejen e organeve të shërbimit pyjor, dënohet me gjobë 80 000 deri në 100 000 lekë” (Trajtuar në faqet 46-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).**

### **1.1.-Rekomandimi:-**

Nga DRISHMPUT Tiranë dhe ISHMP Tiranë nëpërmjet Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit të merren masa dhe kërkojnë rishqyrtimin e afateve përcaktuar nga 8-30 ditë dhe të bëhen deri 30 ditë, me synim përbushjen e qëllimit të inspektimeve në flagrancë dhe sigurimin e harmonizimit dhe përputhjen ndërmjet Neneve 45 dhe 46 të Ligjit nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” me nenin 38 të Ligjit Nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” të ndryshuar,

**Deri në muajin Janar 2020**

**Gjetje 2:** Nisur nga vështirësitë në zbatimin e afateve të inspektimeve në sektorin pyjor, për zbatimin e procedurave ligjore përcaktuar në ligjin nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, përcaktuar në Neni 32 ku shprehet: *“Inspektimi i njoftohet nëpërmjet njoftimit paraprak të autorizimit subjektit të inspektimit jo më vonë se 3 ditë përpara fillimit të veprimeve të inspektimit” dhe Neni 45 “Mbajtja dhe njoftimi i procesverbalit”, Pika 2:”Procesverbali, si rregull, mbahet në vendin e inspektimit dhe i njoftohet, pa vonesë, subjektit të inspektimit nëpërmjet dorëzimit personal. Nëse përfundimi i procesverbalit në vendin e inspektimit nuk është i mundur, ai përfundohet në zyrat e inspektoriatit dhe njoftohet brenda 5 ditëve nga data e përfundimit të inspektimit. 3. Procesverbali përmban informacion të hollësishëm për veprimet e inspektimit, gjetjet e tij dhe vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit dhe shoqërohet me listë-verifikimin e plotësuar gjatë inspektimit” (Trajtuar në faqet 46-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1.Rekomandim:** Duke patur parasysh veçoritë e inspektimeve në sektorin e Policisë Pyjore që kushtëzohen me hapësirën dhe shtrirjen territoriale, gjendjen dhe lëvizjen e selive (adresave) të subjekteve me veprimtaritë në fondin pyjor, vonesat në rastet e dërgesave të njoftimeve të praktikave inspektuese, të gjitha këto specifika diktojnë shqyrtimin dhe ndryshimin e afateve (prej 3 dhe 5 ditë), duke i rritur ato deri në 1 javë, me synim harmonizimin e nenit 32 me nenin me nenin 45 pika 2, për inspektimet që kryhen në sektorin Pyjor; masë kjo që do të sjellë rritjen e efektivitetit të inspektimeve në pyje, veçanërisht kundërshtimin e tyre për shkak të afatit të kufizuar nga subjektet kundravajtëse në gjykata, sikundër trajtuar hollësisht më sipër.

**Deri në muajin Dhjetor 2019**

**- Propozim për ndryshim Udhëzimi dhe Rregulloreje nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.**

**Gjetje 3:** DR ISHMPUT Tiranë, sektori i policisë pyjore ka filluar kryerjen e inspektimeve on-line në fund vitin 2018 dhe ka mundur kryerjen e 4 inspektimeve, pra një numri të kufizuar, duke mos zbatuar urdhrin nr.284, datë 3.5.2018 “Për kryerjen e inspektimeve On-Line” të Inspektorit të Përgjithshëm.

Shkaqet e mos kryerjes së inspektimeve me metodën on-line në ekonomitë pyjore e kullimore, zona të mbrojtura dhe gjueti, bazuar edhe nga informacioni nr.2042/1, datë 22.11.2016 që DR ISHMPUT i ka drejtuar Inspektoratit Qendror (IQ), Kryeinspektorit ISHMPUT dhe Platformës Bashkëqeverisëse lidhur me vështirësitë, nevojën e përsosjes, përfshirjen dhe modifikimin e Programit të Sistemit On-line, si dhe me zgjidhjen e një sërë problemesh si më poshtë:

1-Mungon identifikimi i futjes në sistem për përcaktimin e ekonomive pyjore, kullimore, zonave të mbrojtura dhe i ngastrave, për të cilat do të kryhet inspektimi. Kjo mangësi lidhet me mos pajisjen apo hedhjen ende të përcaktimeve të mësipërme në sistemin on-line.

2-Mungojnë formati i procesverbalit për inspektimin on-line në ekonomitë pyjore, kullimore dhe për zonat e mbrojtura,

3- formati i procesverbalit për inspektimin on-line, për gjueti te pa ligjshme,

4- formati i procesverbalit për vlerësimin e dëmit,

5- formati i procesverbalit për kallëzimin penal,6

- formati i procesverbalit të sekuestrimeve dhe zgjidhja e 2 problemeve:

a-Problemi i identifikimit të kundravajtësit në kushtet e flagrancës, kur nuk kanë ose nuk paraqesin kartën ID (në ekonomitë pyjore, kullimore, në rrugë automobilistike, etj.),

b-Problemi i planeve mujore apo vjetore të punës sipas ekonomive pyjore, kullimore, zonave të mbrojtura, gjueti, etj., pasi sistemi i inspektimit on-line pranon vetëm subjekte me nr Nipt, gjë e cila në ekonomitë pyjore, kullimore, etj., nuk ekziston, pra nuk përshtatet dhe del funksioni i këtij sistemi i pavlefshëm (*Trajtuar në faqet 46-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**3.1. Rekomandim:** DR ISHMPUT Tiranë dhe ISHMPUT Tiranë të marrin masa për korrigjimin, modifikimin e programit të inspektimeve on-line dhe të përfshijë në këtë program dokumentet dhe trajtimin e çështjeve si më poshtë:

1. Format i Procesverbalit për inspektimin on-line, në ekonomitë pyjore, kullimore dhe për zonat e mbrojtura,

2- formati i procesverbalit për inspektimin on-line, për gjueti të pa ligjshme,

3-formati i procesverbalit për vlerësimin e dëmi,

4- formati i procesverbalit për kallëzimin penal,

5- formati i procesverbalit të sekuestrimeve; si dhe lidhur me trajtimin në sistem të çështjeve:

a. Identifikimin përcaktimin e ekonomive, ngastrave pyjore, kullimore, zonave të mbrojtura objekt inspektimi,

b. Identifikimin e kundravajtësit në kushtet e flagrancës, kur nuk kanë apo kur nuk te paraqesin kartën ID (në ekonomitë pyjore, kullimore, në rrugë auto etj),

c. Problemi i planeve mujore apo vjetore të punës sipas ekonomive pyjore, kullimore, zonave të mbrojtura, gjueti etj, pasi sistemi i inspektimit on-line pranon vetëm subjekte me nr Nipt, gjë e cila në ekonomitë pyjore, kullimore, etj., nuk ekziston, nuk i përshtatet më synimit të *rritjes së numrit të inspektimeve*, kryerjen e inspektimeve në zonat me risk në ekonomitë pyjore, kullimore, zona të mbrojtura dhe në gjueti.

#### **Në vazhdimësi**

**Gjetje 4:** Në DR ISHMPUT Tiranë nuk ka një rregullore të brendshme për çdo sektor dhe është e pa azhurnuar me ndryshimet strukturore dhe e pa përshtatur me manualin e inspektimit sipas Rregullores ekzistuese nr.1, datë 15.09.2014 e ISHMPU Tiranë. Kjo situatë është në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për MFK” dhe me Manualin e Inspektimit miratuar me urdhrin nr.13, datë 23.04.2015 “Për miratimin e Manualit të Përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisë” (*Trajtuar në faqet 98-101 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**4.1. Rekomandim:** DR ISHMPUT Tiranë në bashkëpunim me ISHPMPUT Tiranë të hartojnë e miratojnë Rregulloren e re të Brendshme të funksionimit, të përshtatur e përditësuar me ndryshimet strukturore nga VKM nr.103, datë 04.02.2015 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Ujrave dhe Pyjeve”, me Manualin e Inspektimit miratuar me urdhrin nr.13, datë 23.4.2015 ”Për miratimin e Manualit të Përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisë” , ku përveç se duhet përshtatur duke përfshirë edhe proceset lidhur me instalimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në nivel Drejtorie Rajonale dhe në nivel Qendror të ISHPUM Tiranë.

**Brenda muajit Tetor 2019**

## **C. MASA ORGANIZATIVE**

**Gjetje 1.** Në DR ISHMPU Tiranë, ka munguar hartimi i buxhetit për vitin 2016 (PB/PBA hartohet në vitin 2015) dhe për vitet 2017, 2018 janë dërguar vetëm PB pa përfshirë kërkesa për art. 231, pa paraqitur as PBA-të përkatëse, pasi kanë munguar udhëzimet, mbikëqyrja dhe ndjekja nga ISHMPU Tiranë, duke moszbatuar, kriteret procedurat dhe afateve kohore të procesit të hartimit të Projekt Buxheteve (PB/PBA), në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ligjin nr.9936, date 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimet përkatëse, si dhe me ligjin nr.147/2015 “Për Buxhetin e vitit 2016”, ligjin nr. 130/2016 “Për Buxhetin e vitit 2017”, ligjin nr. 109/2017 “Për Buxhetin e vitit 2018” dhe të Kapitulli IV pika 256 të UMF nr.2, datë 06.02.2012 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”, sipas tabelës emërtuar “*Parashikimi dhe realizimi i buxhetit për periudhën e viteve 2016, 2017 dhe 2018 DR ISHMPUT Tiranë tabela nr.1*” (Trajtuar në faqet 6-10 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Rekomandim 1:** DR ISHMPUT Tiranë, Kryeinspektori me strukturat përkatëse, Njësia e Financës dhe përgjegjësit e sektorëve, në bashkëpunim me ISHMPUT Qendër Tiranë, të hartojnë Projekt buxhete PB dhe PBA, të zbatojnë procedurat ligjore në kohë, mbështetur në, Planveprimet, në parashikimin e numrit të inspektimeve dhe të kostove të produktit “Misione Inspektimi”, këshillime, aktiviteteve edukuese me operatorët e biznesit, shoqatat, organizatat, njësitë vendore, NJVQV-të me veprimtari në fushën e mjedisit, pyjeve, ujërave me kostot përkatëse të çdo inspektimi, etj., pra në tregues të matshëm, me synim përgatitjen e buxheteve të argumentuara dhe funksional për realizimin e funksioneve, misionit, objektivave, qëllimit dhe planveprimeve përkatës.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**Gjetje 2:** DR ISHMPUT Tiranë në zbatimin ndjekjen, menaxhimin e realizimit të Buxhetit të viteve 2016, 2017 dhe 2018 ka parashikime me rezerva, buxhete të pa argumentuar jo reale dhe funksionale, që kanë sjellë nivele të ulëta realizimi përkatësisht: në vitin 2016 realizuar 98%, ose në shifra absolute buxheti është realizuar **28,347** mijë lekë kundrejt planit **28,781** mijë lekë, me mosrealizim prej **-434** mijë lekë; në zërin paga e sigurime të cilat janë parashikuar me rezervë mbi nevojat dhe në shpenzimet operative; në vitin 2017 realizuar 85%, ose realizuar **25,944** mijë lekë kundrejt planit **30,900** mijë lekë, me mosrealizim prej **-4,956** mijë lekë, kryesisht në artikullin paga dhe sigurime (nga parashikimi me rezerva prej ISHPU dhe mosplotësimi i numrit të inspektorëve) dhe në v 2018 realizuar 79%, ose realizuar **27,192** mijë lekë kundrejt planit **34,300** mijë lekë, me mosrealizim prej **-7,108** mijë lekë kryesisht në artikullin paga dhe sigurime (nga parashikimi me rezerva prej ISHPU dhe mosplotësimi i numrit të inspektorëve); pasqyruar në tabelën emërtuar “*Parashikimi dhe realizimi i buxhetit për periudhën v. 2016, 2017 dhe v. 2018 DRISHMPUT Tiranë tabela nr.1*” bashkëlidhur. Kjo gjendje është në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07 2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” ligjin nr. 9936 date 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimet

përkatëse, si dhe me ligjin nr. 147/2015 “Për Buxhetin e vitit 2016”, ligjin nr. 130/2016 “Për Buxhetin e vitit 2017”, ligjin nr.109/2017 “Për Buxhetin e vitit 2018”, dhe të Kapitulli IV pika 256 të UMF nr.2, datë 06.02.2012 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”. (*Trajtuar hollësisht në faqet 6-10 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandim 2:** DR ISHMPUT Tiranë, Kryeinspektori me strukturat përkatëse, financa dhe përgjegjësit e sektorëve, të marrin masa të vazhdueshme për menaxhimin dhe ndjekjen e treguesve ekonomik dhe financiar, numrin e inspektimeve dhe këshillimeve, zbatimit të Buxhetit periodik e vjetor dhe në situata mosrealizimi apo pamjaftueshmërie të marrë masa në kohën e duhur për ndryshimet përkatëse në zbatim të procedurave sipas nenit 45 të ligjit të ligjit nr.9936, date 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me synim shmangien e mospërdorimit apo të pamjaftueshmërisë dhe të pasojës në mos përmbushjen e objektivave të institucionit.

### Menjëherë dhe në vazhdimësi

**Gjetje 3:** DR ISHMPUT Tiranë, njësia e Financës *për periudhën datë 01.10.2016 deri ne datë 31.12.2018* nuk janë llogaritur e shpërblyer 25 punonjës në minimalisht *shumën 99.000 lekë*, në kundërshtim me VKM nr. 329, datë 20.04.2016 kreu III pika 2 dhe sipas VKM nr.148, datë 26/02/1998 “Për tarifat e transportit të udhëtareve”, pasqyruar në tabelën emërtuar “Shërbime të kryera dhe pa urdhër-shërbimet të plotësuara sipas VKM nr.329, datë 20.04.2016 hyrë në fuqi datë 20.05.2016 për periudhën 01.10.2016 deri 31.12.2018 *Tabela nr. 3*”, *bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit*.

Mos shpërblimi e mosllogaritja e shpenzimeve udhëtime dieta, ka ardhur nga mosparashikimi e përfshirja në zërin “Shpenzime të tjera transporti, udhëtimi e dieta për punonjësit” llog 602.39 pra në PB dhe PBA e viteve 2016, 2017 dhe 2018, në kundërshtim me ligjin nr. 9936 date 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimet përkatëse (*Trajtuar në faqet 6-10 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandim 3:** DR ISHMPUT Tiranë, njësia e Financës të marrin masa duke përfshirë në Artikullin 602, zërin “Shpenzime për udhëtim e dieta brenda vendit” dhe të llogaritin e shpërblejnë për periudhën *datë 01.10.2016 deri datë 31.12.2018* për 25 punonjës minimalisht në *shumën 99.000 lekë*, për shërbimet e kryera dhe të pa likuiduara, pasqyruar në tabelën emërtuar “Shërbime të kryera dhe pa urdhër-shërbimet të plotësuara sipas VKM nr. 329, datë 20.04.2016 hyre ne fuqi datë 20.05.2016 për periudhën 01.10.2016 deri 31.12.2018 *Tabela nr. 3*”.

### Menjëherë

**Gjetje 4:** Në DR ISHMPUT Tiranë mungonin relacionet, raportet e realizimit të inspektimeve, ndërsa tabelat e treguesve të nivelit të realizimit të numrit të inspektimeve u përgatitën gjatë periudhës së auditimit (me kërkesën e Grupit të auditimit të KLSH) nga Sektorët e mjedisit dhe pyjeve, ku nga raportimet mujore konstatojmë se kryesisht treguesit janë raportuar vetëm në nivelin faktik dhe jo të tabeluar e krahasuar me treguesit e parashikuar në Planet vjetore (pasi edhe planet vjetore mungojnë). Mungesa e këtyre treguesve ka sjellë mos mosmbështetjen edhe në hartimin e Projekt buxheteve përkatëse, formë kjo raportimi në kundërshtim me normat e programimit dhe me kërkesat e ligjeve “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin“, “Për Buxhetin”, ligjit “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor” me udhëzimet përkatëse, dhe me ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë“, nenin 7 dhe neni 16 “Misioni dhe Funkcionet e Inspektoratit Qendror” pika 2 germat “b” dhe “c” dhe me VKM nr.103, datë 04.02.2015 “Për Krijimin dhe Mënyrën e Organizimit e të Funkcionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit”, i ndryshuar, pasqyruar në tabelën “Parashikimi dhe realizimi i numrit të inspektimeve për vitin 2016, 2017 dhe 2018 DR ISHMPUT Tiranë tabela nr.2” (*Trajtuar në faqet 6-10 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).



**Rekomandim 4:** DR ISHMPUT Tiranë, Kryeinspektori me strukturat përkatëse, njësia e Financës dhe Përgjegjësit e Sektorëve, në të ardhmen të marrin masa, që në ndjekjen dhe raportimin e treguesve ekonomik, pasqyrimin dhe raportimin në Relacionet, raportet dhe tabelat e treguesve të nivelit të realizimit të numrit të inspektimeve, treguesit të raportohen jo vetëm në nivelin faktik por dhe me nivelin e parashikuar, programuar pra të krahasueshëm, me treguesit e parashikuar në Planet vjetore (të hartuar e miratuar për çdo vit) dhe mbi bazën e tyre të hartohen e mbështeten Projekt buxhetet përkatëse, formë kjo raportimi në përputhje me normat e programimit, me kërkesat e ligjeve.

#### **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**Gjetje 5:** Në inspektimet e kryera në terren, nuk ka përskrime specifike mbi situatën konkrete në terren dhe mënyrën se si subjekti i zbaton kushtet e lejes mjedisore. Konstatimet e inspektorëve janë të përgjithshme dhe për rrjedhim detyrat e lëna kufizohen në pajisje me leje, për ato raste kur subjekti nuk ka leje mjedisore, si dhe kryerjen e dërgimin e vetë monitorimeve. Detyrat që lihen nuk janë të lidhura me konstatimet konkrete të situatës në terren të kryera nga specialistë të fushës së mjedisit. Sa më sipër është në kundërshtim me pikën 3, neni 45, ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 Neni 45, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” (*Trajtuar në faqen 10-15 dhe 29-46 të Raportit Përfundimtar të auditimit*)

**Rekomandim 5.1:**Të merren masa për plotësimin e procesverbalit të inspektimit me të gjithë informacionin e nevojshëm duke u bazuar në kushtet e lejes mjedisore që disponon subjekti dhe zbatimin e secilit prej kushteve, si dhe të të gjitha mangësive të konstatuara nga ushtrimi i aktivitetit, sipas këqyrjes në terren nga ana e inspektorëve.

#### **Vazhdimisht**

**Gjetje 6:**Afati që i lihet subjekteve për të kryer detyrat e lëna ndryshon në bazë të inspektorit që kryen inspektimin. Për të njëjtën shkelje dhe për të njëjtën detyrë, subjekteve të ndryshme, iu lihen afate të ndryshme (*Trajtuar në faqet 10-15 të Raportit Përfundimtar të auditimit*)

**Rekomandim 6.1:**Të përcaktohet një afat në bazë të kohës reale që kërkon zbatimin i detyrave sipas llojit të tyre dhe ky afat të vendoset në çdo rast që lihen detyra në çdo subjekt, në mënyrë të tillë që subjektet të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe të mos lihet shteg për subjektivizmin.

#### **Vazhdimisht**

**Gjetje 7:** Përzgjedhja e subjekteve për tu inspektuar nuk kryhet sipas rëndësisë së tyre dhe sipas ndikimit që mund të kenë në mjedis, pasi nga praktikat e përzgjedhura subjektet janë me ndikim të ulët ose të mesëm në mjedis. P.sh., vetëm një rast (nga praktikat e audituara) është bërë inspektimi i guroreve në qarkun e Tiranës (*Trajtuar në faqet 10-15 të Raportit Përfundimtar të auditimit*)

**Rekomandim 7.1:** Përzgjedhja e subjekteve për auditim të bëhet në mënyrë të tillë që të përfshijë të gjithë spektrin e llojeve të aktiviteteve, por duke i kushtuar një rëndësi të veçantë atyre aktiviteteve që kanë ndikim të lartë në mjedis.

#### **Vazhdimisht**

**Gjetje 8:** DR ISHMPU nuk ka krijuar dosje të përhershme të inspektimit për çdo subjekt të inspektuar në kundërshtim me Urdhrin e Inspektoratit Qendror nr.13, datë 23.04.2015 “Për miratimin e manualit të përgjithshëm të Inspektimit në Republikën e Shqipërisë. Sektori i Inspektimit Mjedisit në Qarkun e Tirane, nuk ka një bazë të dhënash të saktë dhe të listuar sipas subjekteve në ekonominë pyjore të cilat operojnë në Qarkun Tirane në kundërshtim me Urdhrin e Ministrisë të Turizmit dhe Mjedisit nr.4, date 19.02.2015 "Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi metodologjinë e vlerësimit të riskut. Nuk disponohen kopjet e hartave të ekonomive pyjore, planet e mbarështimit dhe të inventarizimit, hartat e zonave të mbrojtura,

ndarjet e pronësisë së fondit pyjor e kullosor, planet e menaxhimit të pyjeve komunale dhe private (Trajtuar në faqen 15-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1.Rekomandim:** DR ISHMPUT Tirane të marrë masa për krijimin e regjistrave të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në ekonomitë pyjore, si dhe krijimin e dosjeve për çdo subjekt objekt inspektimi për sektorin e mjedisit dhe në sektorin e pyjeve, të sigurojë dokumentacionin tekniko-ligjor për këto subjekte, duke përfshirë dhe planet e mbarështimit dhe menaxhimit të pyjeve komunale dhe private.

### Brenda muajit Shtator 2019

**Gjetje 9:** Sektori i Inspektimit mjedisor në DR ISHMPUT Tiranë, nuk ka një bazë të dhënash të saktë dhe të listuara sipas ndikimeve që kanë në mjedis subjektet të cilat operojnë në Qarkun Tiranë mbështetur në këto të dhëna të bëhej identifikimi i subjekteve dhe veçimi i atyre me risk të lartë e ndikim në mjedis. Kjo në përmbushje të detyrimeve ligjore si dhe detyrimeve që rrjedhin nga Urdhrat e Inspektoratit Qendror nr.13, datë 23.04.2015 "Për miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisë" dhe nr.4 datë 19.02.2015 "Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi metodologjinë e vlerësimit të riskut".

DR ISHMPU Tiranë në planifikimet vjetore e mujore si dhe në inspektimet e kryera, nuk ka përfshirë një masë të konsiderueshme të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në Qarkun e Tiranë të publikuar nga bashkia Tiranë si aktivitete me ndikim në mjedis, në kundërshtim me ligjin nr.10431, datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit" seksioni 2, neni 62-66 "Inspektimi për mbrojtjen e Mjedisit"(Trajtuar në faqen 15-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**9.1.Rekomandim:** DR ISHMPUT Tirane nëpërmjet sektorit të mjedisit të marrë masa që programet vjetore dhe mujore të inspektimit të hartohen në bazë risku, ku të përcaktohet në detaje inspektimi, duke u nisur nga informacioni paraprak për të gjitha subjektet që ushtrojnë aktivitetet në Qarku Tiranë dhe përqendrimi në ato aktivitete që kanë mundësi ndikimi në mjedis, duke parashikuar një gamë më të gjerë subjektësh, jo vetëm ato të raportuara me leje mjedisore nga DRM Tiranë për kryerjen e inspektimeve mbi bazën e bashkëpunimit me institucionet si; Drejtoria Rajonale e Tatimeve të Qarkut Tiranë, QKB Bashki e Njësi Administrative dhe institucione të tjera.

### Vazhdimisht

**Gjetje 10:** Në 49 raste në procesverbalet e hartuara nga inspektorët në proceset e inspektimit u paraqiten parregullsi dhe konstatime për mosplotësim të kushteve të lejeve, pasi nuk përcaktohen se cilat kushte nuk janë realizuar sipas emërimit të pikave të lejes. Në inspektimet e kryera si ato fillestare dhe ato verifikuese, inspektorët janë kontradiktorë në konstatimet e tyre në përcaktimin e llojit të aktivitetit. Gjithashtu, në shumë raste është lënë si detyrë plotësimi i kushteve të lejes ose rishikim i kushteve të lejes, pa përcaktuar se për çfarë kushtesh bëhet fjalë. Ka raste kur subjektit i është lënë detyrë të plotësohet "dokumentacioni mjedisor" dhe nuk përcaktohet se cilat dokumente mungojnë. Në disa raste është kërkuar në formë të përgjithshme plotësimi i kushteve të lejes, pa u shprehur në gjithë përshkrimin e procesverbalit të inspektimit nëse janë shkelur ndonjë kusht i lejes dhe pa përcaktuar se cilat janë ato. Gjithashtu, në këto dokumente konfirmohet vetëm që subjekti ka plotësuar raportin e monitorimit periodik, ndërsa në ri-inspektim inspektorët shprehen vetëm për plotësimin e vetëmonitorimit dhe jo për kushtet e lëna si detyrë në inspektimin paraardhës. Këto mangësi dhe pasaktësi të konstatuara në kryerjen e inspektimeve, janë në kundërshtim me ligjin nr.10431, datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit" seksioni 2 neni 62-66 "Inspektimi për mbrojtjen e mjedisit" dhe me ligjin nr.10433 datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" neni 45-48 (Trajtuar në faqen 15-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**10.1.Rekomandim:** Sektorin e mjedisit në DR ISHMPUT Tirane të marrë masa, që në procesin e inspektimit përshkrimi konstatimeve në procesverbalet e inspektimit të bëhet në mënyrë të saktë,

pasi të jenë verifikuar në mënyrë të plotë informacioni i marrë nga subjekti në formë dokumentare dhe verifikimi në terren i veprimtarisë në drejtim të zbatimit të kushteve të lejes, si dhe të bëhet referimi i saktë dhe i plotë i dispozitës ligjore për moszbatimin apo jo të të lejes së mjedisit. Në rastet e mosplotësimit të kushteve të përcaktuara të shprehen qartë për detyrat e lëna në mënyrë që në momentin e ri-inspektimit të jenë lehtësisht të verifikueshme për zbatim.

#### **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**Gjetje 11:** Në të gjitha procedurat e trajtuara të përzgjedhura për auditim rezultoi se, grupet e inspektimit në terren nuk janë shprehur në lidhje me kontrollin e dokumentacionit tekniko-ligjor për ushtrimin e aktivitetit dhe të dhënat tjera që kanë të bëjnë me kushtet e lejes, siç janë shkarkimet në ajër, tokë dhe ujë si dhe planin e menaxhimit të mbetjeve, pa bërë krahasime të tyre me verifikimet në terren, duke kryer vetëm një verifikim të thjeshtë për lëshimin e lejes mjedisore dhe pagesat vjetore të tarifave mjedisore, si dhe të paraqitjes thjeshtë të dokumentit të vetmonitorimit pa vërtetuar nëse treguesit e saj janë real apo jo në aspektin e përgjithshëm. Në këto raste proces-verbale të mbeten formale, gjë që i bën misionet e inspektimit: jo eficientë, jofunksionale, të paplota, në mospërputhje me nenin 45, të ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, nenit 65, të ligjit nr.10431, datë 09.06.2011 “Për lejet e mjedisit”, nenit 14 “Vlerat 26 kufi të shkarkimeve”, neni 44 “Monitorimi i përputhshmërisë “sipas shtojcës “2”, bashkëlidhur ligjit, “Lista indikativë e substancave kryesore ndotëse që duhen marrë parasysh në qoftë se kanë rëndësi për caktimin e vlerave kufi të shkarkimeve” të ligjit nr.10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, me nenin 19 “Vetëmonitorimi” (*Trajtuar në faqen 15-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**11.1.Rekomandim:** Sektori i inspektimit të mjedisit në DR ISHMPU Tiranë, në procedurat e inspektimit, krahas kontrollit të zbatimit të kushteve të lejeve dhe dokumentacionit tekniko-ligjor të mjedisit duhet të përqendrohet edhe në verifikimin në terren të normave cilësisë së mjedisit për ndotës apo grupe të veçanta ndotësish, krahasuar me rezultatet e vetëmonitorimit për të siguruar përputhshmërinë me kushtet e lejes dhe legjislacionin përkatës.

#### **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**Gjetje 12:** Në shume raste inspektimet të kryera si ato fillestare dhe ato verifikuese inspektorët janë kontradiktorë në konstatimet e tyre, të shprehura këto në procesverbale të përkatëse. Kështu në inspektimin e parë lihet detyrë që subjekti duhet të aplikojë për leje mjedisi për aktivitetin e tij të përcaktuar që në fillim të inspektimit, ndërsa në inspektimin për verifikim detyrash në të njëjtin subjekt me të njëjtin aktivitet, në procesverbal thuhet se: ”subjekti u gjend i mbyllur”, ose nuk gjendet në adresën e dhënë. Inspektimet janë kryer në mungesë të përfaqësuesit të subjektit dhe nuk është lënë detyrë për paraqitje në ISHMP për marrje dijani të problemeve të trajtuara, veprim në kundërshtim me nenin Neni 36- Detyrimet e subjektit të inspektimit pika “d”. Këto mangësi dhe pasaktësi të konstatuara në kryerjen e inspektimeve janë në kundërshtim me ligjin nr. 10431 datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” seksioni 2 neni 62-66 “Inspektimi për mbrojtjen e Mjedisit” dhe me ligjin nr. 10433 datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” nenin 45-48,ku neni 45 (*Trajtuar hollësisht në faqet 15-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**12.1 Rekomandim:** Të merren masa nga inspektorët që kryejnë inspektime në fushën e mjedisit që të kenë kontakte me subjektet për marrjen në dijeni të problemeve të trajtuara në procesverbale të mbajtura dhe të bëhet njoftimi i tyre në çdo rast të lënies detyrës apo të marrjes masë ndaj tyre.

#### **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**Gjetje 13:** Në rastet e lënies së detyrës për riinspektim, kryesisht kur subjekti është gjetur i mbyllur, nuk është përcaktuar kohë e kryerjes për herë të dytë të inspektimit, apo njoftimi i detyruar nga subjekti për realizimin e detyrës. Nga inspektorët nuk ka informacione dhe të dhëna për ndjekjen e inspektimeve për herë të dytë, ku në rast të mos zbatimit të detyrave të lëna duhet

të merresh mësa me gjobë ose mbyllje të aktivitetit. Nga inspektorët nuk ka një material informues për kryerjen e inspektimeve duke shtjelluar hollësisht problemet e konstatuara dhe masat shtrënguese të marra në përputhje me të drejtën e inspektorit për vendim. Për këto raste nuk ka asnjë këshillim, qortim, gjobë apo mbyllje të aktiviteteve, veprime që tregojnë për një punë me performancë të dobët dhe pa përgjegjësi të inspektorëve (*Trajtuar në faqet 15-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**13.1. Rekomandim:** Nga DRISHMPUT Tiranë, sektori mjedisit të merren masa nga inspektorët për rastet kur shprehen se janë të mbyllur dhe të marrin informacion nga QKB dega e Tatimeve, nëse këto subjekte kryejnë veprimtari apo paraqiten me status pasiv pranë QKB-se, si dhe të planifikohen në planet e radhës kryerja e inspektimeve .

#### **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**Gjetje 14:** Nga inspektorët që kryejnë inspektime në fushën e mjedisit nuk ka verifikime të dokumentuara në sistemin e QKL-së , si dhe nuk ka të dhëna mbi ecurinë e zbatimit të detyrave të lëna prej tyre në inspektimet e kryera. Veprime këto në kundërshtim me ligjin e inspektimit në fushën e mjedisit, përkatësisht; - *Nuk është zbatuar neni 11 “Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimi” të ligjit nr. 10431, datë 9.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, nuk ka dokumente për bashkëpunimin dhe rezultatet e tij me institucione të tjera si Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujerave, si de Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (Trajtuar në faqet 15-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**14.1.Rekomandim:** Të merren masa dhe të kryhen verifikime të dokumentuara në sistemin e QKL-së, mbi ecurinë e zbatimit të detyrave të lëna nga inspektorët dhe marrja e informacionit deri në paisje me leje mjedisore të subjekteve.

#### **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**Gjetje 15:** Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të inspektimit rezultoi se **20 subjekte janë të pajisura me leje mjedisore**. Nga DR ISHMPUT Tiranë nuk është realizuar inspektimi i verifikimit të realizimit të detyrës së lënë për nxjerrjen nga këto subjekte private të lejes së mjedisit. Gjithashtu, për këto subjekte nuk është marrë vendim administrativ “dënim me gjobë” për shkeljet e konstatuara në kundërshtim me ligjin nr.10431 datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” seksioni 2 neni 62-66 “Inspektimi për mbrojtjen e Mjedisit”, me ligjin nr.10433 datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” nenin 45-48 dhe me ligjin nr.10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, neni 29, pika1/ii, “Kundërvajtjet”,

**15.1.Rekomandim:** DR ISHMPUT Tiranë të marrë masa për të programuar kryerjen e inspektimeve në **20 subjektet** të listuara në tabelën e paraqitur në faqen 14-15 të Raportit Përfundimtar të auditimit dhe nëse vazhdojnë të kryerjen aktivitetin e tyre, të merren masa administrative dënim me gjobë për shkeljet ligjore.

#### **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**Gjetje 16:** Në auditimin e dokumentacionit të procedurave të inspektimit rezultoi se 16 subjekte **janë në proces** për tu pajisur me leje mjedisore. DR ISHMPU Tiranë ka ushtruar inspektime për verifikimin e detyrës së lënë për nxjerrjen nga këto subjekte private të lejes së mjedisit. Në këto subjekte, ka rezultuar se kanë filluar procedurat e licencimit mjedisor, por nuk është proceduar për rishikim në periudha të mëvonshme nëse këto subjekte janë pajisur përfundimisht me leje mjedisore. Mungesa e ri-inspektimeve ka sjellë mosverifikimin deri në pajisjen me leje mjedisore të subjekteve në proces licencimi dhe mosevidentimin e rasteve të refuzimeve, të cilat përbëjnë objekt dënim me gjobë për kundërvajtje në shumën nga 300,000 lekë-500,000 lekë, e llogaritur për **16 rastet** me masën minimale të gjobës rezulton vlerën prej **4,800,000 mije lekë që konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e shtetit**. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.10431 datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” seksioni 2 neni 62-66 “Inspektimi për

mbrojtjen e Mjedisit”, me ligjin nr.10433 datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” nenin 45-48 dhe me ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, neni 29, pika 1/ii, “Kundërvajtjet”. Nuk ka njoftim të DR ISHMPU Tiranë nga këto subjekte apo nga DRM Tirane për marrjen apo jo të lejeve të mjedisit (*Trajtuar në faqen 20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**16.1.Rekomandim:** DR ISHMPUT Tiranë të marrë masa dhe të hartojë plane inspektimi për **16 subjektet**, nëpërmjet ri-inspektimit që të paraqesin dokumentacionin ligjor për finalizimin e procesit të licencimit me leje mjedisi.

#### **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**Gjetje 17:** Në formularin e Inspektimit, në paragrafin I “Të dhënat të përgjithshme të subjektit”, në pika 3 “Lloji i aktivitetit ekonomik” gjenerohet nga sistemi e plotësuar me numër dhe jo me përshkrimin e aktivitetit në fjalë gjë që e bën të pamundur të kuptohet lloji i aktivitetit që do të inspektohet (*Trajtuar në faqet 29-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

**17.1.Rekomandim:** Të merren masa nga IQ për korrigjimin e këtij problemi të sistemit online, si dhe pasaktësive të tjera të hasura nga inspektorët gjatë plotësimit të formateve online, në mënyrë që sistemi të mos bëhet pengesë për mbarëvajtjen e procesit të inspektimit, i cili është tejet dinamik, nisur dhe nga numri i lartë i aktiviteteve që operojnë në Qarkun e Tiranës.

#### **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**Gjetje 18:** Në formatin e procesverbalit të inspektimit, në paragrafin 7 “Gjetje të konstatuara” nuk shënohen gjetje por citohet vetëm se gjetjet janë shkelje të neneve të caktuar ligjorë, të cilët përmenden në vijim të procesverbaleve. Në të gjitha rastet nga inspektimet, ku nuk janë konstatuar shkelje, nuk është plotësuar pika 9 “Në rast se nuk konstatohen shkelje të jepen arsyet e përfundimit të procedimit” e Seksionit II “Procedura e inspektimit” në Procesverbalin e Inspektimit. Në këto raste kjo pikë është lënë e paplotësuar. Kjo bie në kundërshtim me pikën 3 neni 45 dhe nenin 47 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, është shmangur plotësimi i formularit të inspektimit me të gjitha të dhënat që i takojnë subjektit në bazë të verifikimit në vend. (*Trajtuar në faqet 29-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**18.1.Rekomandim:** Të merren masa që në çdo inspektim të plotësohen të gjitha të dhënat e nevojshme të listuara në procesverbalin e inspektimit, sipas pikave për ato pjesë të legjislacionit që përkojnë me aktivitetin e inspektuar. Në rastet kur pika të caktuara nuk përkojnë me aktivitetin e subjektit, të plotësohet kuadrati i shënuar me “jo”.

#### **Vazhdimisht**

**Gjetje 19:** Në inspektimet e përzgjedhura për tu audituar në pikën “Gjetjet e konstatuara”, ka vetëm një gjetje të përgjithshme që është mospërmbushja e kushteve të lejes mjedisore, në kundërshtim me pikën b-ii/neni 29, ligji nr.10 448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”. Të përmbledhurit e të gjitha shkeljeve në një gjetje të vetme, siç është kjo më sipër nuk i vjen në ndihmë konstatimit real të problemeve dhe shkeljeve të konstatuara dhe nuk i jep mundësi inspektorëve të lënë këshillime për çdo shkelje të konstatuar. Shkelja e përgjithshme nuk zërthehet në bazë të kushteve të pazbatuara të lejes mjedisore dhe nuk jep informacion mbi atë çfarë nuk është zbatuar nga subjekti (*Trajtuar në faqet 29-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**19.1 Rekomandim:** Të merren masa që procesverbali që i lihet subjektit të jetë sa më i plotë dhe sa më i kuptueshëm për subjektin. Në këtë procesverbal të përshkruhet konkretisht gjetjet, pra cilat kushte të lejes mjedisore nuk janë zbatuar nga subjekti dhe çfarë shkeljesh ligjore përfaqësojnë këto gjetje.

#### **Vazhdimisht**

**Gjetje 20:** DR ISHMPUT Tiranë nuk ka hartuar plane mujore e vjetore për ushtrimin e inspektimeve në qarkun e Tiranës, inspektimet janë të rastësishme, në bazë të urdhrave të ministrit ose ankesave të ndryshme. Një gjë e tillë bën që kryerja e tyre të mos i shërbejë qëllimit të punës, si dhe të mos ketë ndikim në ruajtjen e parametrave mjedisore në Qarkun e Tiranës dhe zbatimit të legjislacionit mjedisor. Sa më sipër është në kundërshtim me pikën 5/dh të VKM nr. 46, datë 29.01.2014 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të inspektoratit shtetëror të mjedisit, pyjeve dhe ujërave (*Trajtuar në faqet 29-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

**20.1.Rekomandim:** DR ISHMPUT Tiranë të hartojë plane mujore e vjetore për ushtrimin e inspektimeve në qarkun e Tiranës, në mënyrë që inspektimet të mos jenë të rastësishme, por në bazë të një plani i cili të përfshijë të gjitha llojet e aktiviteteve të subjekteve, duke vënë theksin tek ato me ndikim të lartë në mjedis.

#### **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**Gjetje 21:** DR ISHMPUT Tiranë, sektori i inspektimit Pyjor gjatë periudhës Tetor-Dhjetor 2016, vitet 2017 dhe 2018 ka kryer një numër të kufizuar prej 282 *inspektime gjithsej*, prej tyre 4 inspektime me metodën on-line; ndarë sipas periudhave 3/muj IV 2016 kryer 40 inspektime, viti 2017 kryer 134 inspektime dhe në vitin 2018 janë 108 inspektime.

Nuk është hartuar një tabelë e grupim analitik i inspektimeve të kryera në sektorin e pyjeve sipas klasifikimit: Inspektime në Zonat e mbrojtura me pyje mbrojtëse;

- a. në vijën bregdetare,
- b. në brigjet lumore dhe përrenj me prurje lumore,
- c. në zonat e mbrojtura,
- d. në pyjet prodhues,
- e. në kullota livadhe,
- f. në monumentet e natyrës,
- g. zona të përziëra.

Ky klasifikim që do të siguronte rritjen e numrit dhe efektivitetit të inspektimeve, përcaktimin e zonave të riskuara, përdorimin me efektivitet të kapaciteteve inspektuese, aktualisht të kufizuara krahasuar me fondin pyjor prej **36 508 ha**, shtrirjen territoriale të Qarkut Tiranë me fond pyjor e vijë të konsiderueshme bregdetare dhe vijë lumore të disa lumenjve me peshe në rrjetin lumor të Republikës (*Trajtuar në faqet 46-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**21.1. Rekomandim:** DR ISHMPUT Tiranë të marrë masa të hartojë tabelën përkatëse të grupimit analitik të inspektimeve të kryera në sektorin e pyjeve sipas klasifikimit, me synim rritjen e numrit dhe efektivitetit të inspektimeve, përcaktimin e zonave të riskuara dhe përdorimin me efektivitet të kapaciteteve inspektuese, aktualisht të kufizuara në raport me shtrirjen territoriale të Qarkut Tiranë me vijë të konsiderueshme bregdetare, përfshirë vijën lumore të disa lumenjve, me peshe si Republikë.

#### **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**Gjetje 22:** Në Qarkun e Tiranës është një sipërfaqe e strukturë e konsiderueshme fondi pyjor prej **36 508 ha**, ku predominojnë pyjet mbrojtës bregdetar e lumor, pyjet e Zonave të mbrojtura kryesisht bregdetare me vlera të cilësore turistike bregdetare e malore, dhe pyje të tjera me funksion çfarëdo e kullota, pasqyruar në tabelën “Struktura e Fondit Pyjor-Kullosor në Qarkun Tiranë dhe juridiksion të DR ISHMPUT Tiranë”.

Mungojnë të dhënat dhe nuk janë parashikuar e kryer inspektime, për sipërfaqet dhe fondet pyjore të pyjeve mbrojtës me shtrirje në vijat bregdetare, shpatet lumore, të përrenjve dhe në vijat e kurotat e liqeneve dhe Ujëmbledhësve, pasi Qarku i Tiranës përshkohet nga Sistemi hidrologjik Ishëm-Erzen: Lumi i Erzenit (Tiranë, Durrës), Lumi i Tiranës, Lumi Tërkuzë; Në Kavajë–

Rrogozhinë përmbledh basenit ujqor Shkumbin (Qarku Elbasan). (*Trajtuar në faqet 46-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**22.1. Rekomandim:** Nga DR ISHMPUT Tiranë të identifikohen e përditësohet sipas bashkive përkatëse: Tiranë, Kamëz, Vorë, Kavajë dhe Rrogozhinë, sipërfaqet e pyjeve mbrojtëse me shtrirje në shpatet anësore të lumenjve (*pjesët përkatëse brenda territorit juridiksional*) si dhe të identifikohen sipërfaqet që u përkasin përrrenjve dhe brezat e pyjeve mbrojtës të Ujëmbledhësve dhe liqeneve, pellgjet ujëmbledhës përkatës, mbështetur në listat përfundimtare (ose listat paraprake) të pronave miratuar me VKM-të përkatëse të transferimit në NJVQV-të ose përfaqësuesit e subjektit shtetëror; me synim parashikimin, përfshirjen dhe kryerjen e inspektimeve.

Të përditësohet struktura e fondit pyjor kullor të Qarkut Tiranë për secilën prej 5 bashkive Tiranë, Kamëz, Vorë, Kavajë dhe Rrogozhinë.

### **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**Gjetje 23:** DR ISHMPUT Tiranë, sektori i inspektimit Pyjor, për periudhën 3/mujori IV vitit 2016 dhe 2017, në **6 raste** për 49,8 mst dru zjarri dhe 25 m<sup>3</sup> lëndë punimi, nuk janë marrë vendime sekuestrimi, apo për vendimet me dënim administrativ (VDA) të marra nuk janë zbatuar pika 4 për sekuestrim që kanë sjellë si pasojë lënien dhe përfitimin e pa drejtë nga kundravajtësit të materialit drusor në vlerën e llogaritur sipas VKM nr.391 përkatësisht: tek subjekti XY 43 mst dru zjarri dhe 25 m<sup>3</sup> lëndë punimi, për mos hartim të procesverbalit të sekuestrimit e moszbatimi të vendimit të dënimit administrativ (VDA) nr. 2, datë 07.09.2017, nr. seri 02717, pika 4; tek subjekti Sh.L.,2 mst dru zjarri për mos *zbatim të VDA nr.7*, datë 15.07.2017, nr. seri 04102; tek subjekti K. D., 2 mst dru zjarri për mos *vendosje e mos përcaktim të pikës 4* për sekuestrim në VDA nr.7, datë 20.07.2017, nr. seri 4087, gjendje kjo në kundërshtim me nenin 45 pikat 1,2,3,4 dhe nenin 48 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011”Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe në përmbushje të kërkesave të ligjit nr. 5/2016, datë 04.02.2016 “Për Shpalljen e Moratoriumit në Pyje në Republikën e Shqipërisë”, kërkesave të ligjit nr. 9385, datë 23.04.2009 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, neni 12, 38 pasqyruar në tabelën “Administrimi dhe dokumentimi i materialeve të sekuestruara nga inspektimet i DR ISHMPUT Tiranë 2016-2017“(Trajtuar në faqet 56-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**23.1.Rekomandim:** DRISHMPUT Tiranë, pasi të analizojë, nxjerrë përgjegjësitë, **të marrë masat për** zbatimin e procedurave të sekuestrimit, dorëzimit dhe dokumentimit me fletëhyrje të depozituesit në APR Tiranë, të materialit Drusor në **6 raste për 49,8 mst dru zjarri dhe 25 m<sup>3</sup> lëndë punimi**, për te cilat nuk janë marrë vendime sekuestrimi, apo në vendimet me dënim administrativ (VDA) të marra nuk është përcaktuar pika 4 për sekuestrim, ndodhur përkatësisht: tek subjekti XY, 43 mst dru zjarri dhe 25 m<sup>3</sup> lëndë punimi, për mos hartim të procesverbalit të sekuestrimit e moszbatim të vendimit të dënimit administrativ (VDA) nr. 2, datë 07.09.2017, nr. seri 02717, pika 4; subjekti **Sh. L.**, 2 mst dru zjarri për mos *zbatim të VDA nr.7*, datë 15.07.2017, nr. seri 04102; subjekti **K.D.**, 2 mst dru zjarri për mos *vendosje e mos përcaktim të pikës 4* për sekuestrim në VDA nr.7, datë 20.07.2017, nr. seri 4087.

### **Menjëherë**

**Gjetje 24:** Në **5 raste me 16 mst** dru zjarri (nr.8,10,12,14 dhe nr. 28) për materialin konstatuar dhe të kapur gjatë transportit dokumentuar me 5 procesverbale të inspektimit **nr. Serie 0364, datë 22.05.2018, nr.0367, datë 12.06.2018, nr.0234, datë 18.06.2018, on-line nr.0000114-1, datë 27.12.2018 dhe Autorizimet e inspektimit nr.606/1, datë 14.05.2018, nr.1045, datë 11.06.2018, nr.1094/1, datë 18.06.2018, on-line nr.0000114-1, datë 27.12.2018** nuk janë vënë nën administrim pra nuk janë dokumentuar me fletë hyrje, pasi rastet janë në ndjekje penale, nuk është vendosur sekuestro mbi materialin të ndodhur në Komisariate apo Prokurori, si dhe nuk është kërkuar pranë këtyre organeve administrimi i materialit drusor, duke sjell kohëzgjatje qëndrimi pa

sekuestrim prej 1 vit, me pasojë dëmtim cilësie deri në kalbje, gjendje kjo në kundërshtim të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, kreu III “Dokumentimi i lëvizjes së Aktiveve” pika 34, 37 e vijim ku shprehet: “...Hyrja e aktiveve në magazine dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike...”, pasqyruar në tabelën emërtuar “Administrimi dhe Dokumentimi i Materialeve të Sekuestruara nga Inspektimet DR ISHMPUT Tiranë viti 2018“, për të cilat DRISHMPUT Tiranë nuk ka marrë masa të kërkojë në prokurori, për 5 raste me 16 mst dru zjarri mbetur si provë nga sekuestrimet kryer për vitin 2018 (sipas tabelës nr. 8,10,12,14, nr.28), duke vënë në dukje faktin e rrezikut të humbjes cilësisë produktit nga kohëzgjatja e qëndrimit. (Trajtuar në faqet 56-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**24.1.Rekomandim:** DR ISHMPUT Tiranë të marrë masat për shpejtimin e vazhdimin të procedurave ligjore të dorëzimit dhe të dokumentimit me fletëhyrje të depozituesit në APR Tiranë, të materialit drusor **5 raste me 16 mst** që i përkasin vendimeve për dënim administrativ (VDA), të vitit 2018, (nr.8,10,12,14 dhe nr. 28 sipas tabelës), në zbatim të rregullave kritereve specifike për qarkullimin dokumentimin dhe administrimin e materialit drusor.

**Menjëherë**

**Gjetje 25:** Nga DR ISHMPUT Tiranë nuk ishte bërë arkivimi i dokumentacionit, pasi mungon dokumenti fotokopje përmendur bashkëlidhur aneksit shoqërues të procesverbalit të inspektimit numër serie 0019503, datë 07.09.2017; nuk janë vazhduar procedurat ligjore të përfundimit të inspektimit të subjektit **XY shpk**; ndërsa në Vendim për Dënim Administrativ (VDA) nr.serie 0000797, nr.2, datë 07.09.2017 pika 4 të vendimit shprehet “*Të sekuestrohet materiali drusor te dy mjete dhe rimorkiot e tyre përkatësisht 43 mst dru zjarri dhe 25 m<sup>3</sup> trupa.*”, nuk është hartuar procesverbali i sekuestrimit të materialit drusor prej *43 mst dru zjarri dhe 25 m<sup>3</sup> trupa*”, nuk është prerë fletë hyrja dhe nuk është dorëzuar materiali në subjektin përfaqësues shtetëror **Personi fizik S. M.**, sipas marrëveshjes nr.143/1, datë 3.4.2018; veprime dhe mos veprime në kundërshtim me nenin 45 pikat 1,2,3,4, me nenin 48 të ligjit nr.10433, datë 16.06.2011”Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 5/2016, datë 04.02.2016 “Për Shpalljen e Moratoriumit në Pyje në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr.9385, datë 23.04.2009 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, neni 12, 38, ndryshuar me *ligjin nr.9791, datë 23.7.2007*” Për disa shtesa dhe ndryshime te ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005..” (Trajtuar në faqet 56-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**25.1.Rekomandim:** DR ISHMPUT Tiranë të marrë masa të bëjë arkivimin e dokumentacionit dhe të përfshijë në inventar dokumentin fotokopje përmendur bashkëlidhur aneksit shoqërues të procesverbalit të inspektimit numër serie 0019503, datë 07.09.2017; si dhe të vazhdojë procedurat ligjore për përfundimin e inspektimit në subjektin XY shpk; mbështetur në Vendim për Dënim Administrativ (VDA) nr.serie 0000797, nr.2, datë 07.09.2017, pika 4, shprehur “*Të sekuestrohet materiali drusor te dy mjete dhe rimorkiot e tyre përkatësisht 43 mst dru zjarri dhe 25 m<sup>3</sup> trupa.*”, të hartojë procesverbalin e sekuestrimit të materialit drusor prej *43 mst dru zjarri dhe 25 m<sup>3</sup> trupa.*”, duke prerë fletë hyrjen dhe të dorëzojë materialin drusor në subjektin përfaqësues shtetëror.

**Menjëherë**

**Gjetje 26:** DR ISHMPUT Tiranë, sektori pyjor për 3/mujorin e IV, viti 2016 deri 2017 lidhur më dëmtimet në pyje nga kundravajtësit nga **23 raste me vlerë dëmi 43,492,235 lekë**, vetëm në **5 raste** në vlerën prej **30,878,235 lekë** ka hartuar Procesverbale Vlerësimi Dëmi (PVD), të cilat i ka kallëzuar në prokurori, ndërsa në **18 raste me vlerën 12,614,000 lekë**, nuk janë hartuar PVD dhe nuk janë dërguar për arkëtim përkatësisht; (Bashkisë Tiranë 5 raste me vlerë 8,818,000 lekë nr. 1;2; 14; 16 dhe 17 dhe në AdZM Tiranë 13 raste vlerë 3,796,000 lekë, nr.1/2016, nr. 6; 7; 8; 9; 10;



11; 12; 13; 15; 18; 19, nr. 20, për të cilat Vendimet e Dënimeve Administrative (VDA) kanë marrë formë të prerë), që kanë sjellë pasoje mos arkëtime në vlerën **12,614,000 lekë**, në kundërshtim me Nenin 40/1, të ligjit nr. 9791 datë 23.7.2007, ”Për disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.9385, date 04.05.2005 ”Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 ”Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për Kundravajtjet Administrative”, pasqyruar në tabelën emërtuar: “Procesverbale të Vlerësimit të Dëmit në Pyje për vitin 2016, 2017 dhe 2018 Sektori i Inspektoratit te Policisë Pyjore, DRISHMPUT Tirane“ (*Trajtuar hollësisht në faqet 62-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**26.1.Rekomandim:** DR ISHMPUT Tiranë, pasi të analizoje e nxjerrë përgjegjësinë për vonesën, të marrë masa të hartojë Procesverbale Vlerësimi Dëmi (PVD), për **18 raste me vlerën 12,614,000 lekë, që i përkasin v. 2017**, dhe ti dërgojë për arkëtim përkatësisht; (Bashkisë Tiranë 5 raste me vlerë 8,818,000 lekë nr. 1;2; 14; 16 dhe 17 dhe në AdZM Tiranë 13 raste vlerë 3,796,000 lekë, nr. 1/2016, nr. 6; 7; 8; 9; 10; 11; 12; 13; 15; 18; 19,nr. 20, për të cilat Vendimet e Dënimeve Administrative (VDA) kanë marrë formë të prerë), **që kanë sjellë pasoje mosarkëtime në vlerën 12,614,000 lekë.**

Ndërsa 5 raste në vlerën prej **30,878,235 lekë** për të cilat janë hartuar Procesverbale Vlerësimi Dëmi (PVD), dhe janë ka kallëzuar në Prokurori, të ndjekë procesin dhe pas përfundimit të procedurave ligjore të prokurorisë, ti dërgojë për ekzekutim arkëtim të vlerës dëmit tek përfaqësuesit pronar të pyllit, sipas tabelës “Lista e kallëzimeve penale të subjekteve kundravajtës dhe dërgimi i PVD në Prokurori për Dëmet në Pyje”

#### Menjëherë

**Gjetje 27:** DR ISHMPUT Tiranë Sektori Pyjor për vitin 2018 lidhur më dëmtimet në pyje nga kundravajtësit, nga **26 raste me vlerë dëmi 3,562,679,000 lekë**, prej tyre në **3 raste me vlerë 3,555,999,000 lekë (nr, 5, 16, 21)** ka hartuar Procesverbale Vlerësimi Dëmi (PVD) dhe kallëzuar në prokurori (prej tyre **Subjekti “XXX” shpk me vlerë dëmi 3,555,000,000 lekë**), ndërsa në **23 raste me vlerën 6,680,000 lekë**, janë hartuar PVD dhe janë në proces dërgimi për arkëtim përkatësisht: (Bashkisë Tiranë dhe AdZM Tiranë 23 raste me vlerë **6,680,000 lekë** nr. 1, 3, 4, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 17, 18, 19, 20, 22, 23, 24, 25, 26 për të cilat Vendimet e Dënimeve Administrative (VDA) kanë marrë formë të prerë), që kanë sjellë pasoje vonesa dhe mosarkëtime në vlerën **6,680,000 lekë**, në kundërshtim me Nenin 40/1 te ligjit nr. 9791 datë 23.7.2007, ”Për disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 9385, date 04.05.2005 ”Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 ”Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për Kundravajtjet Administrative”, pasqyruar në tabelën emërtuar: “Procesverbale të Vlerësimit të Dëmit në Pyje për vitin 2016, 2017 dhe 2018 Sektori i Inspektoratit te Policisë Pyjore, DRISHMPUT Tirane“ (*Trajtuar në faqet 68-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**27.1 Rekomandim:** DR ISHMPUT Tiranë, pasi të analizoje e nxjerrë përgjegjësinë të marrë masa të dërgojë për arkëtim Procesverbalet Vlerësimi Dëmi (PVD), për **23 raste me vlerë 6,680,000 lekë, që i përkasin v. 2018** me shkresat përcjellëse për arkëtim përkatësisht; (Bashkisë Tiranë dhe AdZM Tiranë nr. 1, 3, 4, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 17, 18, 19, 20, 22, 23, 24, 25, 26 për të cilat Vendimet e Dënimeve Administrative (VDA) kanë marrë formë të prerë), që kanë sjellë pasoje vonesa dhe mosarkëtime në vlerën **6,680,000 lekë**,

Ndërsa **3 raste** në vlerën prej **3,555,999,000 lekë** për të cilat janë hartuar Procesverbale Vlerësimi Dëmi (PVD), dhe janë kallëzuar në Prokurori, të ndjekë procesin dhe pas përfundimit të procedurave ligjore të prokurorisë, ti dërgojë për ekzekutim arkëtim të vlerës dëmit tek përfaqësuesit pronar të pyllit, sipas tabelës “Lista e Kallëzimeve penale të subjekteve kundravajtës dhe dërgimi i PVD në Prokurori për Dëmet në Pyje”.

#### Menjëherë

**Gjetje 28:** Në DR ISHMPUT Tiranë për vitet 2016, 2017 dhe 2018 mungojnë e nuk janë dërguar nga ISHMP Tiranë organika, (apo miratimi dhe vazhdimi me organikat ekzistuese), dhe kërkesat e

shpeshhta me e-maile datë 18.10.2017, datë 22.10.2018 të DR ISHMPUT Tiranë drejtuar sektorit burimeve njerëzore të ISHMPUT, nuk kanë kthyer përgjigje; pra nuk ka pasur shkresë të dërgimit të strukturës organike për 3 vitet 2016, 2017 dhe 2018, situatë kjo në kundërshtim me VKM nr.187, datë 8.3.2017, VKM nr.103, datë 4.2.2015 “Për Krijimin dhe mënyrën e Organizimit të Funkcionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave”, ndryshuar me VKM nr. 659, datë 10.11.2017 dhe VKM nr.338, datë 06.06.2018. *(Trajtuar në faqet 79-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**28.1.Rekomandim:** DR ISHMPUT Tiranë të marrë masa, ti kërkojë Inspektorit të Përgjithshëm të ISHMPUT Tiranë dhe të ndjekë në rrugë administrative tek Ministri Turizmit dhe Mjedisit dërgimin në rrugë zyrtare të strukturës dhe organikës vjetore përkatëse të miratuar për DR ISHMPUT Tiranë.

**Menjëherë**

**Gjetje 29:** DR ISHMPUT Tiranë në vitin 2018 (por edhe në vitet 2016 e 2017) paraqitet me një strukturë faktike të punësuarish me përbërje me arsim të lartë në specialitete dhe të përafërta **21** inspektorë ose 72% nga të cilët: inxhinieri pyjesh brenda profesionit **2 inspektorë** ose 7%, inxhinierë mjedisi 4 inspektorë ose 14 %, 2 agronom dhe 1 inxhinier agrar 1 biolog dhe 1 veterinar gjithsej 5 ose 17%, 7 inspektorë juristë ose 24%, 3 inspektorë ekonomiste e biznes ose 11%; ndërsa në profesione specialitete të tjera 8 inspektorë ose 28 % nga të cilët; 3 me arsim shkencë sociale-politike, 2 me arsim sport, 1 gjeografi dhe 1 inspektor me arsim gjuhë e huaj. **Kjo strukturë është e pa përshtatshme, jo funksionale dhe jo në përputhje me kriteret, kërkesat detyrat, funksionet përcaktuar në VKM nr. 103, datë 4.2.2015** “Për krijimin dhe mënyrën e Organizimit të Funkcionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave”, të ndryshuar Kreu V, “Dispozita Transitore dhe të Fundit” pikat 2, pasqyruar në tabelën emërtuar “Struktura Faktike e Inspektorëve sipas specialiteteve në DR ISHMPUT Tiranë më 31.12.2018” *(Trajtuar në faqet 79-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**29.1.Rekomandim:** DR ISHMPUT Tiranë me ISHMPUT të marrin masat të nisi procedurat për rishqyrtimin e rekrutimeve të bëra dhe të përshtatë marrëdhëniet kontratore të punësimit të punonjësve me kontratë; të hartojë, rishqyrtojë dhe miratojë tek Ministri dhe zbatojë kriteret përkatës *(nëse ato mungojnë, apo nëse nuk përshtaten të hartohen dhe të kërkohet miratimi i ministrit)*. Konkretisht nga auditimi konstatohet se lidhur me specialitete të tjera janë të punësuar në **8 raste**, *(e barabartë kjo me 27 % të numrit të përgjithshëm)*, **inspektorë**, nga të cilët;

- **3 inspektorë të diplomuar në shkencat sociale-politike,**
- **2 inspektorë të arsimuar në fakultetin e edukimit fizik dhe sporteve,**
- **1 inspektor i profilit gjeografi dhe 1 inspektor me arsim gjuhë e huaj.**

Në të kundërt, *të merren masa për ndërprerjen e kontratave të punës si punonjës të papërshtatshëm dhe të rekrutuar e kontraktuar në mënyrë të kundraligjshme dhe jo në përputhje me kriteret, kërkesat detyrat, funksionet e përcaktuara në VKM nr.103, datë 4.2.2015* “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave”, të ndryshuar Kreu V, “Dispozita Transitore dhe të Fundit”, pikat 2 pasqyruar në tabelën emërtuar “Struktura Faktike e Inspektorëve sipas specialiteteve në DR ISHMPUT Tiranë më 31.12.2018”,

**Brenda muajit Tetor 2019**

**Gjetje 30:** DR ISHMPUT Tiranë, gjatë periudhën 2015, 2016, 2017 dhe 2018 ka pasur Strukturë të paqëndrueshme inspektorësh, karakterizuar me ndërprerje të shpeshhta, emëtime inspektorësh në mënyrë të parregullt dhe strukturë faktike të parregullt përshkruar hollësisht më sipër, gjendje kjo ardhur si pasojë sepse ISHMPUT ka kryer emëtime pa u mbështetur në respektim kriteresh të përcaktuara, pa pasur një dokument të përgatitur dhe miratuar, lidhur me **kërkesat specifike për arsimin e inspektorëve dhe me kërkesat specifike për çdo vend pune në ISHMP të miratuara**

*nga Inspektorati Qendror*". Kjo gjendje është në kundërshtim me VKM nr. 103, datë 4.2.2015 "Për Krijimin dhe mënyrën e Organizimit të Funkcionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave", Kreu V, "Dispozita Transitore dhe të Fundit", pikat 2 ku shprehet: pasqyruar ne tabelën emërtuar "Largimet nga shërbimi Civil dhe Ndërprerje e marrëdhënies punës, shkaqet sipas Urdhrave ecuria e procesit DR ISHMPUT Tiranë".(Trajtuar në faqet 79-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**30.1 Rekomandim:** DR ISHMPUT Tiranë dhe ISHMPUT me propozim të Kryeinspektorit të Përgjithshëm të përgatitësin, paraqitin e marrin miratimin tek Ministri i Turizmit dhe Mjedisit dokumentin për kërkesat specifike arsimin e inspektorëve dhe kërkesat specifike për çdo vend pune në ISHMP të miratuara nga Inspektorati Qendror", pasqyruar ne tabelën emërtuar "Largimet nga shërbimi Civil dhe Ndërprerje e marrëdhënies punës, shkaqet sipas Urdhrave ecuria e procesit DRISHMPUT Tiranë".

## Menjëherë

**Gjetje 31:** Nga auditimi i urdhrave të ndërprerjeve të marrëdhënies te punës, nxjerrë nga ISHMPU për periudhën 2015-2018, konstatojmë strukturë të paqëndrueshme inspektorësh ne DRISHMPUT Tiranë nga ndërprerja e marrëdhënies se punës dhe largimet nga shërbimi **31** punonjës ose **77,5%**, kohëzgjatje mesatare të marrëdhënies së punës më pak se **1 vit e 6 muaj** me ndikim në mungesën e kualifikimit të nevojshëm, prej tyre: **13 punonjës** me kontratë pune inspektorë pyjesh, **17 punonjës civil** inspektorë mjedisi dhe **1 punonjës mbështetës**; ndërsa sipas shkaqeve përshkruar në urdhrat e ISHMPU-së ndërprerjet grupohen: **5 inspektorë** janë larguar për diploma të parregullta, **1 inspektor** për mungesë diplome, **7 inspektorë** me dorëheqje, **2 inspektorë** transferuar në ISHPU, **3 inspektore** emëruar përkohësisht nga DAP transferuar në mbushje të afatit 6 muaj, **1 inspektor** për emërim nga Ministri në shkelje të kompetencës së DAP, **1 inspektor** mosplotësim të kriterit integritetit, **7 inspektorë** për mase disiplinore nga DRISHMPU, shkelje discipline e orari pune prej të cilëve **3 inspektorë janë në proces gjyqësor** dhe **2 inspektorë** larguar nga Departamenti Antikorrupsion, kurse **1 punonjës** shërbimi larguar me masë disiplinore i cili ka kërkuar dokumente për ndjekje procesi, trajtuar në tabelën emërtuar: "Largimet nga shërbimi Civil dhe Ndërprerje e marrëdhënies punës, shkaqet sipas Urdhrave ecuria e procesit DR ISHMPUT Tiranë". (Trajtuar në faqet 79-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**31.1 Rekomandim:** DR ISHMPUT Tiranë, Burimet njerëzore dhe juristi në bashkëpunim dhe *nëpërmjet ISHMPUT* të marrin masa për ndjekjen e ecurisë së procesit e procedurave dhe proceseve gjyqësore të ankimimeve eventuale te punëmarrësve për ndërprerje te njëanshme të marrëdhënies dhe kontratës së punës nga punëdhënësi DR ISHMPUT "**me vendim largimi**" për 3 punonjës, që **janë në proces gjyqësor**; si dhe për 8 punonjës në viti 2017 dhe 16 punonjës në vitin 2018, pasqyruar në tabelën emërtuar "Largimet nga shërbimi Civil dhe Ndërprerje e marrëdhënies punës, shkaqet sipas Urdhrave ecuria e procesit DR ISHMPUT Tiranë".

## Menjëherë dhe në Vazhdimësi

**Gjetje 32:** Nga auditimi i dokumentacionit te lëvizjes se mjeteve te transportit për kryerjen e inspektimit pranë këtij Inspektorati konstatohet se nuk janë hartuar urdhra dhe nuk janë ngritur komisione për testimin e mjeteve për (harxhimin) e karburantit në litra/100km, për mjetet që kanë në dispozicion institucioni (Trajtuar në faqet 86-92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**32.1. Rekomandim:** Të merren masa dhe të nxirret urdhër nga titullari i institucionit për normimin e harxhimit të karburantit në litra/100 km, për mjetet që ka institucioni në dispozicion për kryerjen e inspektimeve në terren.

## Menjëherë dhe në vazhdimësi

**Gjetje 33:** Nga auditimi i kryer në DR ISHMPUT Tiranë për pasqyrat financiare rezultoi se, nga specialistja e financës pasqyrat financiare nuk janë mbajtur sipas ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrave Financiare”, neni 7 pika 1 “Inventari i aktiveve dhe detyrimeve”;

-Pasqyrat financiare nuk japin një pamje reale dhe të saktë të gjendjes financiare të institucionit në mbyllje të periudhës ushtrimore 2016-2017 e për rrjedhojë nuk i ofrojnë ndihmë menaxherëve të institucionit në marrjen e masave për arritjen e objektivave;

-Nuk ishte hartuar bilanci paraprak verifikues, me qëllim për të parë edhe procedurat e rakordimit, siç kërkon UMF nr. 14 datë 28.12.2006, pika 3;

-Bilanci kontabël së bashku me formatet (pasqyrat) financiare nuk janë shoqëruar me pyetësin përkatës, formatin nr.12 “Pyetësi dhe shënime shpjeguese për hartimin e llogarive të administrimit financiar të vitit”. Ky pyetësor nuk ishte bashkëlidhur bilancit përkatës, me qëllim për të bërë disa saktësime e shpjegime të llogarive përkatëse (*Trajtuar në faqet 92-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**33.1. Rekomandim:** Specialistja e financës në DR ISHMPUT Tiranë të përgatisë bilancin verifikues, si dhe të plotësojë pasqyrat financiare në periudhat e ardhme konform rregullave në fuqi, duke e shoqëruar bilancin vjetor me relacionin me përgjigjet e pyetësit, në përputhje me kërkesat e udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 9.3.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore të Njësive të Qeverisjes Përgjithshme”

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**Gjetje 34:** Nga auditimi u konstatua se ditarët e veprimeve kontabël nuk mbaheshin konform VKM nr. 783, datë 22/11/2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”. Nga mos mbajtja e ditarëve të magazinës nuk janë kryer këto pasqyrime në bilancet e viteve 2016-2017 dhe si rezultat nuk është kryer kontabilizimi i fletë hyrjeve dhe fletë daljeve, pra nuk janë mbajtur kartelat dyfishe sipas udhëzimit nr.30. date 27.12.2011, “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”. Si pasojë e këtyre mosveprimeve, nuk është kryer kuadrimi midis specialistes së financës dhe magazinës, në mënyrë që të saktësohet gjendja në fund të vitit. Konstatohet se vlera prej 154,548 lekë, është gjendje sipas vlerave kontabël të kartelave të magazinës për vitin 2017, por nuk është e pasqyruar si gjendje në bilancin e këtij viti (*Trajtuar në faqet 92-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**34.1. Rekomandim:** Specialistja e financës në DR ISHMPUT Tiranë të marrë masat për të çelur ditarët kontabël dhe të pasqyrojë veprimet ekonomike sistematikisht dhe në kronologji. Gjithashtu, në bilancin e veprimtarisë së vitit 2019 të pasqyrohen e kontabilizohen veprimet e lëvizjes së vlerave materiale sipas kartelave të magazinës, të kuadruara dhe barazuara. Me veprim të veçantë të sistemohet nëpërmjet ditarit të veprimeve të ndryshme vlera prej 154,548 lekë, e pa sistemuar dhe pa kontabilizuar që i përket vitit 2017. Mbajtja e kontabilitetit të bëhet në mënyrë të informatizuar nëpërmjet programeve informatike përkatëse.

### **Menjëherë**

**Gjetje 35:** Nga auditimi rezultoi se janë ngritur komisione për nxjerrjen jashtë përdorimit të mallrave, si dhe nuk janë hartuar relacionet për asgjësim të tyre veprime këto që bien në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr.30 date 27.12.2011, “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik.” (*Trajtuar në faqet 92-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**35.1 Rekomandim:** DR ISHMPUT Tiranë të marrë masa dhe të hartojë urdhrat dhe të ngrejë komisionet e vlerësimit, dhe në rastet e daljes nga përdorimi apo asgjësimi të mallrave, të bazohet kjo veprimtari mbi relacionet e argumentuara nga komisionet e ngarkuara; vënien në dijeni të titullarit dhe marrjen e miratimeve respektive, sipas udhëzimeve në fuqi.

### **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**Gjetje 36:** DR ISHMPUT Tiranë për vitin 2017 në zbatim të urdhrin të Ministrit nr.23, datë 18.04.2016, për transferimin e inventarit godinave dhe asetëve në administrim të ISHMP është marrë në dorëzim Godina e Drejtorisë së Shërbimit Pyjorë Kavajë në vlerë prej 5,206,083 lekë, e cila nuk ka dokumentacion bashkëlidhur. Sa më sipër, kjo vlerë është paraqitur në AQT e pasqyruara në kontabilitet. Godina e cila është e regjistruar në kontabilitet, nuk ka dokumentacion ku të arsyetohet mbi vlerën fillestare të ndërtesës, si pasojë në këto kushte nuk është llogaritur amortizimi dhe nuk është kryer dhe as nuk ka filluar procedura për regjistrimin e saj në ASHK (ish ZVRPP) Kavajë *(Trajtuar në faqet 86-92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

**36.1. Rekomandim;** DR ISHMPUT Tiranë në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masat dhe të administrojnë dokumentacionin e plotë për transferimet kapitale të godinës, në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik".

**Menjëherë**

**Gjetje 37:** Nga DR ISHMPUT Tiranë nuk janë hartuar dokumentet "Regjistrit të Riskut", Planveprimet e Menaxhimit të Riskut", si dhe nuk është përcaktuar Koordinatori i riskut, lidhur me parashikimin, zbërthimin, programimin, monitorimin, raportimin e treguesve si hartimi i planeve vjetor të inspektimeve në funksion të përmbushjes të objektivave dhe misionit kryesor, gjendje kjo në mos përmbushje të nenit 21 (i cili përcakton bazat për menaxhimin e riskut), të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar si dhe të Manualit "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", (Shtojcat përkatëse 6,7 dhe Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016 "Për Përgjegjësitë dhe Detyrat e Koordinatorit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Koordinatorit të Riskut në Njësitë Publike" *(Trajtuar në faqe 98-101 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

**37.1.Rekomandim:** DR ISHMPUT Tiranë, Kryeinspektori dhe strukturat Përgjegjësit e sektorëve me specialistin e Financës të marrin masat dhe të hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë dokumentet "Regjistrit të Riskut", "Plan veprimet e Menaxhimit të Riskut, Koordinatorin", si dhe të dërgojnë kopje të tyre në ministrinë e linjës administrative, lidhur me parashikimin, zbërthimin, programimin, monitorimin, raportimin e treguesve të planeve vjetor të inspektimeve të hartuara, në përmbushje të objektivave dhe misionit kryesor të institucionit.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**Gjetje 38:** Lidhur me Funksionimin e Sistemeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit për vitin 2016 e 2017, në DR ISHMPUT Tiranë mungojnë nuk janë hartuar plotësuar e dërguar "Pyetëtori i Vetëvlerësimit të SMFK" për v. 2016 në v. 2017 dhe për v. 2017 në v. 2018 si dhe nuk u paraqitën dokumente shkresore si të dërgimit nga DR ISHMPUT Tirane ashtu edhe të kërimit të tyre nga ISHMPUT Tiranë; gjendje në mos përmbushje të neneve 17 dhe 29 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe nenit 18 të ligjit 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar. *(Trajtuar në faqe 98-101 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

**38.1 Rekomandim:** DR ISHMPUT Tiranë të marrë masa të hartojë, plotësojë, dërgojë në strukturat përkatëse dhe të marrë masat për batimin efektiv të aspekteve të vendosur në dokumentin "Pyetëtori i Vetëvlerësimit të MFK" për çdo vit.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

## **D. MASA DISIPLINORE**

-Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", në zbatim të

nenit 58, “Llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2017 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014, ligjit nr.10433, datë 16.06.2011”Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr.10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” dhe ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative”, nenin 44 “Përgjegjësia e punonjësit të organit administrativ”, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendim-marrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, dhe VKM nr. 103, datë 04.02.2015 “Për Krijimin dhe Mënyrën e Organizimit të Funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit”, i ndryshuar, **i rekomandoj Kryeinspektorit të ISHMP-së Tiranë, të vlerësojë, në varësi të analizës së përgjegjësisë, shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit Te marrë masa disiplinore nga “Vërejtje” në “Vërejtje me paralajmërim”, për 12 punonjësit civil të sektorit mjedisit, si më poshtë:**

1. z. **E.K.**, me detyrë Inspektor i Mjedisit
2. z. **A.B.**, me detyrë Inspektor i Mjedisit
3. z. **E.K.**, me detyrë Inspektor i Mjedisit
4. z. **E.T.**, me detyrë Inspektor i Mjedisit
5. z. **E. D.**, me detyrë Inspektor i Mjedisit
6. z. **A. H.**, me detyrë Inspektor i Mjedisit
7. z. **E.C.**, me detyrë Inspektor i Mjedisit
8. z. **Al. B.**, me detyrë Inspektor i Mjedisit
9. z. **F. K.**, me detyrë Inspektor i Mjedisit
10. z. **Gj.T.**, me detyrë Inspektor i Mjedisit
11. z. **A. P.**, me detyrë Inspektor i Mjedisit

Për arsye se:

*Sipas aktkonstatimeve nr. 10,11,12 me date 13,15,3.2019, ne fushën e mjedisit.*

Në mbajtjen e procesverbaleve të inspektimit, nuk evidentohen subjektet me numër NIPT-i, kanë lënë afate në kohë të ndryshme për t’u pajisur me leje mjedisore, nuk kanë bërë riinspektime për të kontrolluar nëse subjekti i ka realizuar detyrat e lëna. Këto mangësi e shkelje janë veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

-Këta inspektorë kanë hartuar procesverbalet e konstatimit të kundërvajtjeve administrative si dhe vendimet për dënim administrativ, në të cilat mungon nënshkrimi i personit përgjegjës të kontrolluar dhe data e marrjes së kopjes së vendimit për dënim administrativ.

Në rastin kur është kundërshtuar nënshkrimi i procesverbaleve dhe i vendimit për dënim administrativ, nga ana e inspektorëve nuk është evidentuar ky fakt, veprim ky në kundërshtim me pikën 2, neni 14 të ligjit nr. 10279 dt 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

-Nga grupi i inspektimit nuk evidentohet në se ka patur inspektim të mëparshëm dhe sa kohë ka që subjekti ushtron aktivitetin.

-Në autorizim nuk shpjegohen shkaqet të tjera që diktojnë kryerjen e inspektimit.

- Nuk ka bashkëpunim në zbatim të neni 11 “Parimi i përgjegjësive së ndërsjellëte ...”ligjit nr.10431, datë 9.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, nuk ka dokumente për veprimtarinë dhe rezultatet e saj për bashkëpunimin me institucione të tjera si NJQV, DRTT Tirane, për statusin financiar të subjektit, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

-Nga inspektimi cilësohet se subjektet nuk ka kontratë me firmën e licencuar për transportimin e mbetjeve spitalore si dhe kur kanë nuk është evidentuar dokumentacioni i levizjes së mbetjeve si dhe shlyerja e detyrimeve financiare për këtë qëllim.

-Nga inspektori nuk ka shënime në procesverbal dhe në dokumente të tjera për përkrahje të detajuara si kontakti me subjektin me telefon internet apo formë tjera të drejtpërdrejta, veprime këto në zbatim të ligjit 10433, datë 16.06.2011,nenit 41” të drejta të tjera të inspektorit.

-Në ri-inspektimin e subjekteve inspektorët nuk shprehet se çfarë është bërë me detyrën e lënë në lidhje me rishikimin e kushteve të lejes, por është vazhduar me konstatimet dhe realizimin e kushteve të lejes së pa-rishikuar ( të vjetër).

Inspektorët nuk janë shprehur në procesverbal se ka konstatuar se subjekti ka zbatuar detyrën e lënë nga inspektimi i mëparshëm por pa cituar konkretisht llojin e detyrës. ***Në procesverbale nuk ka të dhëna për zbatimin e nenit 48 Shkelja e kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit pika 5, në rastin e parashikuar në pikën 4 të këtij neni dhe pikës 6.***

Subjekteve nuk i është kërkuar leja mjedisore dhe fotokopja ti bashkëngjitej praktikës si provë e inspektimit si dhe të konfirmohej elektronikisht në QHKL dhe ISHMPU për paisjen me Leje mjedisore.

*-Në proces-verbale e mbajtura nga inspektorët, në pjesën e përshkrimit, konstatohet se nuk është trajtuar hollësisht situata aktuale, (në aneksin shtesë A-4 bashkëlidhur tij), problematikat që paraqiten dhe motivimi i rishikimit për kushtet e lejes, të cilat duhen rekomanduar nga subjekti).*

*-Nga inspektorët nuk ka informacione dhe të dhëna për ndjekjen e inspektimeve për herë të dytë, ku në rast të mos zbatimit të detyrave të lëna duhet të merresh mësa me gjobë ose mbyllje të aktivitetit.*

*-Në asnjë rast nuk janë hartuar raporte javore apo mujore për evidentimin e subjekteve që kane probleme në fushën e inspektimit dhe mbi këtë baze të hartohen planet mujore të inspektimit. Ka raste kur është kërkuar në formë të përgjithshme plotësimi i kushteve të lejes pa u shprehur në gjithë përshkrimin e procesverbalit të inspektimit nëse janë shkelur ndonjë kusht i lejes dhe pa përcaktuar se cilat janë ato, shkak i cili i ka sjellë lënien e një detyre të tillë.*

**12.Për znj. M. Ll.(T.),** me detyrë specialiste finance pranë DR ISHMPUT Tirane, pasi nga auditimi konstatohet se:

Ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9228 date 29.04.2004, “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrave Financiare”, neni 7 pika 1 “Inventari i aktiveve dhe detyrimeve”;

-Pasqyrat financiare nuk japin një pamje reale dhe të saktë të gjendjes financiare të institucionit në mbyllje të periudhës ushtrimore 2017-2018 e për rrjedhojë nuk i ofrojnë ndihmë menaxherëve të institucionit në marrjen e masave për arritjen e objektivave;

-Në këtë institucion të audituar, mungon bilanci paraprak verifikues, për të audituar procedurat e rakordimit, në zbatim të UMF nr. 14 datë 28/12/2006, pika 3;

-Bilanci kontabël së bashku me formatet (pasqyrat) financiare nuk janë shoqëruar me pyetësin përkatës, formati nr. 12 “Pyetësi dhe shënime shpjeguese për hartimin e llogarive të administrimit financiar të vitit”. Ky pyetësor nuk ishte bashkëlidhur bilancit përkatës, me qëllim për të bërë disa saktësime e shpjegime të llogarive përkatëse;

-Rezultoi se ditarët e veprimeve kontabël nuk mbaheshin konform VKM nr. 783, datë 22/11/2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”, e konkretisht Kapitulli I “Mbajtja e kontabilitetit”;

-Nga mos mbajtja e ditarëve të magazinës dhe si rezultat nuk janë kryer kontabilizimi i fletë hyrjeve dhe fletë daljeve, pra nuk janë mbajtur kartelat dyfishe sipas udhëzimit nr. 30. date 27.12.2011, “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësiti e Sektorit Publik”, si pasoje nuk është kryer kuadrimi midis specialistes së financës dhe magazinës, në mënyrë që të saktësohet gjendja në fund të vitit.

-Nuk janë hartuar relacionet si dhe nuk janë vënë në dispozicion titullarit për ncjerrjen e materialeve jashtë përdorimit sipas udhëzimit nr.30.date 27.12.2011, “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësiti e Sektorit Publik”.

-Si dhe me cilësinë e detyrimit të të qenit si anëtarë të Grupit për Hartimin e PB dhe PBA të v. 2016, 2017 dhe 2018 për mangësitë e shkeljet trajtuar në *Aktkonstatimi nr.1, datë 4.02.2019, Aktkonstatimi nr.3, datë 12.03.2019, Aktkonstatimi nr.2, datë 06.02.2019, dhe faqet e Raportit Përfundimtar të auditimit*

*b. Për 6 punonjësit, trajtuar nga Komisioni Disiplinës ISHMPUT ,si më poshtë:*

*1-znj. E.D., me detyre Juriste pranë DR ISHMPUT-se,*

*2-Z. G. R. , me detyrë Inspektor i Mjedisit*

*3-Z. G. H. , me detyrë Inspektor i Mjedisit*

*4-Z. G. T., me detyrë Inspektor i Mjedisit*

*5-Z. B.S., me detyrë Inspektor i Mjedisit*

*6-Z.Sh. L., nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore, do të ishte “vërejtje”, por këto masa quhen të ezauruar pasi për të njëjtën periudhë auditimi për inspektimet e kryera ne fushën e mjedisit me vendimin nr.22 date 25.03.2019,nga Komisioni Disiplinës i Inspektoratit Shtetërore te Mjedisit, Pyjeve ,Ujërave dhe Turizmit në Nivel Qendrore, ju është dhënë masa “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyre për një periudhë deri në 2 vite “.*

## **D.2 Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas Kodit Punës.**

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronjat “e” dhe “ç” të nenit 1, kreun IV, dhe nenet 37 dhe 144 të ligjit nr.7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe kontratës individuale të punës, VKM nr. 103, datë 04.02.2015 “Për Krijimin dhe Mënyrën e Organizimit e të Funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit” i ndryshuar, **i rekomandoj Kryeinspektorit të ISHMP-së Tiranë**, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH për periudhën 01.10.2016 deri më 01.10.2018, i lihet në kompetencë përcaktimi i llojit të masës dhe të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore, nga “Vërejtje”deri në “Vërejtje me paralajmërim” për **4** punonjësit si më poshtë:

### **Spektori i Policisë Pyjore për 4 punonjës marrëdhënie me kontratë**

**1.Për z. E. B., me detyrë Përgjegjës Spektori i Pyjeve Kavajë**, për mangësitë e shkeljet trajtuar në Aktkonstatimi nr. 1, datë 4.02.2019, Aktkonstatimi nr.9, datë 14.03.2019 dhe faqet e Raportit Përfundimtar të auditimit

**2. Për z. D. K., me detyrë inspektor sektori Policisë Pyjore** për mangësitë e shkeljet trajtuar në Aktkonstatimi nr.9, datë 14.03.2019, Aktkonstatimi nr. 5, datë 14.03.2019, Aktkonstatimi nr. 4, datë 14.03.2019, dhe faqet e Raportit Përfundimtar të auditimit

**3. Për z. B.D., me detyrë inspektor, sektori Policisë Pyjore** për mangësitë e shkeljet trajtuar në Aktkonstatimi nr.9, datë 14.03.2019,Aktkonstatimi nr. 4, datë 14.03.2019, dhe faqet e Raportit Përfundimtar të auditimit

**4. Për z. E. K., me detyrë inspektor sektori Policisë Pyjore** për mangësitë e shkeljet trajtuar në Aktkonstatimi nr.9, datë 14.03.2019 dhe faqet e Raportit Përfundimtar të auditimit

### **D/3. Për punonjësit e larguar e që nuk kanë adresim institucional**

I. Për **3** punonjësit e larguar nga puna nuk rekomandojmë masë disiplinore, pasi u janë ndërprerë marrëdhëniet e punës.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore, do të ishte “**Largim nga Shërbimi civil**”.

**1. Për z E.R.**, me detyrë ish-Kryeinspektor nga viti 2014 deri në date 02.05.2017 i DR ISHMPUT Tirane

**2. Për z. L.Zh.**, me detyrë ish-Kryeinspektor i DR ISHMPUT Tirane nga data 03.05.2017 deri ne date 04.06.2018.

Për këta punonjës nuk është propozuar masë disiplinore, pasi masa ndaj tyre konsiderohet e ezauruar, megjithëse nga auditimi konstatohet se:

-Nuk kane plotësuar detyrimin sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10279, dt 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”, pasi nuk ka raportuar çdo muaj me shkrim tek Drejtorët e Drejtorive



të Inspektimit sipas fushave përkatëse dhe nuk ka përcjellë raportimet e sektorëve sipas modeleve të miratuara nga ISHMPQ, si dhe një kopje origjinale të procesverbaleve të konstatimit të kundërvajtjes dhe vendimeve të dënimit me gjobë. Për Sektorin e Mjedisit për periudhën e audituar nuk janë lëshuar autorizime inspektimi, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 10433, datë 16.6.2011“Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”;

-Nuk kanë hartuar dhe miratuar për të gjithë periudhën objekt auditimi programe mujore dhe vjetore, nuk ka nxjerre njoftime për inspektimet që do të kryhen në subjekt, veprime në kundërshtim me udhëzimet e IQ si dhe të Ligjit të Inspektimit në Fushën e mjedisit.

Për punonjësit e larguar nga puna *nuk rekomandojmë masë disiplinore, pasi* u janë ndërprerë marrëdhëniet e punës .

-Si dhe shkeljet trajtuar në *Atkonstatimi nr. 1, datë 4.02.2019, Atkonstatimi nr.9, datë 14.03.2019, Atkonstatimi nr. 5, datë 14.03.2019, Atkonstatimi nr. 3, datë 12.03.2019 Atkonstatimi nr. 2, datë 06.02.2019, Aktverifikimi nr. 1, datë 14.03.2019 dhe faqet e Raportit Përfundimtar* të auditimit

-Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore, do të ishte **“vërejtje me paralajmrim”**

**1.Per z. F.P.**, me detyre përgjegjes i Sektorit të Mjedisit për periudhën 05.05.2017 deri me datë 10.01.2018 për shkeljet trajtuar në Akt Konstatimi Nr. 10,11,12 datë 15.03.2019 “Inspektimi në fushën e mjedisit”.

**II. Për 11 ish punonjës** inspektor të policisë pyjore , ndërprerë marrëdhëniet e punës me kontratë për shkeljet do të propozonim masat “ndërprerjen e kontratës punës përkatësisht:

**1. Për z.E. A.**, me detyrë ish-Përgjegjës Sektori i Pyjeve Tiranë deri në mars 2018, aktualisht i larguar, për mangësitë e shkeljet trajtuar në *Atkonstatimi nr. 1, datë 4.02.2019, Atkonstatimi nr.9, datë 14.03.2019, Atkonstatimi nr. 4, datë 14.03.2019, Atkonstatimi nr. 2, datë 06.02.2019, Aktverifikimi nr. 1, datë 14.03.2019 dhe faqet e Raportit Përfundimtar* të auditimit

**2. Për z. A. Gj.**, me detyrë ish-Përgjegjës Sektori i Pyjeve Tiranë prej prill-dhjetor 2018, aktualisht i larguar për mangësitë e shkeljet trajtuar në *Atkonstatimi nr. 1, datë 4.02.2019, Atkonstatimi nr.9, datë 14.03.2019, Atkonstatimi nr. 5, datë 14.03.2019,, Atkonstatimi nr. 2, datë 06.02.2019, Aktverifikimi nr. 1, datë 14.03.2019 dhe faqet e Raportit Përfundimtar* të auditimit

**3. Për z. A. Ç.**, me detyrë ish-inspektor deri 30.04.2018, për mangësitë e shkeljet trajtuar në *Atkonstatimi nr.9, datë 14.03.2019, Atkonstatimi nr. 5, datë 14.03.2019,, Aktverifikimi nr. 1, datë 14.03.2019 dhe faqet e Raportit Përfundimtar* të auditimit

**4. Për z. M. B.**, me detyrë ish-përgjegjës sektori pyjesh 29.9.16 deri 01.06.2017, për mangësitë e shkeljet trajtuar në *Atkonstatimi nr.9, datë 14.03.2019 dhe faqet e Raportit Përfundimtar* të auditimit

**5. Për z. Z. M.**, me detyrë ish-inspektor, për mangësitë e shkeljet trajtuar në *Atkonstatimi nr.9, datë 14.03.2019, Atkonstatimi nr. 5, datë 14.03.2019, Atkonstatimi nr. 4, datë 14.03.2019, dhe faqet e Raportit Përfundimtar* të auditimit

**6. Për z. H. Gj.**, me detyrë ish-inspektor, për mangësitë e shkeljet trajtuar në *Atkonstatimi nr.9, datë 14.03.2019, Atkonstatimi nr. 5, datë 14.03.2019, Atkonstatimi nr. 4, datë 14.03.2019, dhe faqet e Raportit Përfundimtar* të auditimit

**7. Për z. B. T.**, me detyrë ish-inspektor deri 30.04.2018, për mangësitë e shkeljet trajtuar në *Atkonstatimi nr.9, datë 14.03.2019, Atkonstatimi nr. 5, datë 14.03.2019, dhe faqet e Raportit Përfundimtar* të auditimit

**8.Për z. H.Gj.**, me detyrë ish-inspektor deri 30.04.2018 për mangësitë e shkeljet trajtuar në *Atkonstatimi nr.9, datë 14.03.2019 dhe faqet e Raportit Përfundimtar* të auditimit

**9. Për z. R.R.**, me detyrë ish- inspektor (larguar) për mangësitë e shkeljet trajtuar në *Atkonstatimi nr. 4, datë 14.03.2019 dhe faqet e Raportit Përfundimtar* të auditimit

**10.Për z. V.B.**, me detyrë ish- inspektor (larguar), për mangësitë e shkeljet trajtuar në *Atkonstatimi nr. 4, datë 14.03.2019 dhe faqet e Raportit Përfundimtar* të auditimit

**11. Për z. S. G.,** me detyrë ish-inspektor deri 30.04.2018, për mangësitë e shkeljet trajtuar në *Atkonstatimi nr. 4, datë 14.03.2019 dhe faqet e Raportit Përfundimtar të auditimit*

**Shënim:** Masa e largimit ndaj 11 punonjësve pyjor të mësipërm është ezauruar me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me këtë institucion.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit.

---

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**